

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5769  
E hënë, 6 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## Stevo Pendarovski, president i ri i Maqedonisë Veriore

Sipas rezultateve të para të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kandidati i mazhorancës, Stevo Pendarovski, është në epërsi me 64 për qind ndaj kandidatës së opozitës Gordana Siljanovska me 32 për qind | **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SKENDER REÇICA | **FAQE 4-5**



## Rritja e pagës minimale është e domosdoshme

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se ministria që drejton ka ndërmarrë reforma ligjore në fushën e marrëdhënies së punës, fushën pensionale, atë sociale dhe familjare si dhe të aftësisë së kufizuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se niveli i lartë i papunësisë, me shkallën rreth 30 për qind, është një nga brengat më të mëdha të qeverisë. Reçica ka thënë se vetëm në vitin e kaluar kanë arritur të përfshijnë në punësim dhe aftësim profesional mbi 12 000 punëkërkues. Sa i përket një numri të madh të lëndimeve dhe vdekjeve në vendin e punës, Reçica ka thënë se MPMS-ja do të jetë e pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Ndërkaq ka theksuar se rritja e pagës minimale në vend është e domosdoshme dhe tejet e rëndësishme për shkak të rritjes së kostonet jetësore në vend

### AKTUALE

**PERSONALITETE TË SHQUARA TË RILINDJES KOMBËTARE DHE VEPRIMTARIA E TYRE NË MANASTIR** **F.8**

Prof. dr. Nusret  
PLLANA



**'BARDHËSITË E ATDHEUT', INFORMACION I DOMOSDOSHËM PËR KREJT ATDHEUN TONË** **F.8**

Mr. Sc. Ph.D(c). Kemail SHAQIRI

**KURTI KËRKON MOBILIZIM PËR ZGJEDHJE TË REJA** **F.10**



### EKONOMI

**TAKSA NDIKOI NË RITJE TË PRODHIMIT** **F.9**

### KULTURË

**NJË SHQIPTIM ARTISTIK NË SHUMË PAMJE I LUFTËS SË UÇK-së** **F.12**



Prof. ass. dr. Ragip GJOSHI

### SPORT

**GËRBESHI: PËR HIR TË KAMPIONATIT DUAM FITORE NDAJ PRISHTINËS** **F.16**

SOT (E HËNË) FILLON MUAJI I SHENJTË I RAMAZANIT

## Myftiu Tërnavë bën thirrje për bashkim politik



Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të Ramazanit, i ka ftuar faktorët institucionale që të bashkohen në dobi

të atdheut dhe qytetarëve të Kosovës. Ai ka thënë se e kemi për obligim që brezit të ri t'i sigurojmë perspektivë në vendin tonë | **FAQE 3**



**Agim Bahtiri rizgjedhet kryetar i Degës së AKR-së në Mitrovicë** **FAQE 6**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Stevo Pendarovski, president i ri i Maqedonisë Veriore

Sipas rezultateve të para të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, kandidati i mazhorancës, Stevo Pendarovski, është në epërsi me 64 për qind ndaj kandidatës së opozitës Gordana Siljanovska me 32 për qind



**SHKUP, 5 MAJ** - Sipas rezultateve të para të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga kutitë e para të hapura në nivel kombëtar, kandidati i mazhorancës, Stevo Pendarovski është në epërsi me 64 për qind kundrejt kandidatës së opozitës Gordana Siljanovska me 32 për qind.

Të dielën në Maqedoninë e Veriut janë mbajtur zgjedhjet e gjashta presidenciale që nga pavarësia e këtij vendi. Pak mbi 1 milion e 808 mijë votues kanë qenë në regjistrin zgjedhor, një shifër kjo që ka qenë e debatueshme prej vitesh në shtetin e vogël prej 2 milionësh.

Votuesit kanë pasur mundësinë të zgjedhin në mes njërit garues, i konsideruar si i moderuar dhe properëndimor dhe tjetrit që mund t'i bllokojë proceset integruese të vendit. Stevo Pendarovski ishte kandidat i Lidhjes Social Demokrate i mbështetur edhe nga Bashkimi Demokratik për Integrim dhe

një sërë partish të tjera më të vogla e organizata joqeveritare. Ndërsa, Gordana Siljanovska Davkova garoi si kandidate presidenciale e VMRO-DPMNE-së së opozitës, e vlerësuar si nacionaliste.

Të dy garuesit dhe përkrahësit e tyre e kanë pasur të qartë se pa votat e shqiptarëve nuk bëhen president dhe ata kanë zhvilluar një fushatë në këto dy javët e fundit duke u përqendruar në tërheqjen e votuesve shqiptarë. Stevo Pendarovski ka ofruar konceptin "Një shtet për të gjithë", një shtet ku nuk do të ketë padronë dhe qiraxhinj apo të nënrenditur, as qytetarë të rendit të parë e të rendit të fundit, siç shprehej ai në një intervistë për "Zërin e Amerikës".

Ndërkaq, Gordana Siljanovska ka zhvilluar një fushatë me sulme ndaj kundërkandidatit presidencial Pendarovski dhe Lidhjes Social Demokrate në pushtet, duke i paraqitur ata si

përgjegjës për shitjen, sipas saj të emrit, të popullit dhe identitetit maqedonas. Ajo është shprehur se ajo vetë nuk do ta përdorë emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut" nëse bëhet presidente, dhe se do të kërkojë mënyra për kthimin e emrit Republika e Maqedonisë. Siljanovska po ashtu mund të paraqesë probleme, sipas analistëve, ndaj ligjit që i mundëson një shtrirje të gjerë përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Në balotazh është dashur të dalin mbi dyzet për qind e votuesve, përndryshe zgjedhjet shpallen të pavlefshme.

Zgjedhjet janë vëzhguar nga 3300 vëzhgues vendas dhe 520 vëzhgues të organizatave të huaja me ODIHR-in në krye. Në rrethin e parë, më 21 prill, në votime kanë dalë 41.67 për qind ndërsa Steve Pendarovski ka fituar me një epërsi të ngushtë prej rreth 4200 vota, respektivisht 322.58 vota apo 42,81 për qind të votave

ndërsa kundërkandidatja e tij Gordana Siljanovska-Davkova 318.341 vota apo 42,25 për qind.

Në garë ishte edhe një kandidat shqiptar, Blerim Reka, që kishte fituar rreth 80 mijë vota. Pikërisht votat e tij, konsiderohen si vendimtare si për arritjen e pragut zgjedhor po ashtu edhe për fitoren e ndonjërit nga kandidatët maqedonas, të cilët edhe fushatën në rrethin e dytë e kanë përqendruar në tërheqjen e votuesve shqiptarë.

## Vuçiqi: Shërbimet sekrete perëndimore ndaluan korrigjimin e kufijve



**BEOGRAD, 5 MAJ** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se Kosova do të fitojë pavarësinë dhe sovranitetin në tërë territorin, por jo pse se ai do ta njohë Kosovën, por për shkak se nuk kaloi zgjidhja që ai ka ofruar, mirëpo ai nuk specifikuar saktësisht se çfarë kishte ofruar dhe kujt.

Presidenti serb ka thënë në TV 'Pink' se "ajo që ka ofruar ai nuk ka mundur të kalojë për shkak të presionit të madh të disa shteteve dhe

shërbimeve të tyre të inteligjencës, të cilat kanë aktivizuar agjenturat e tyre politike e mediatike në vende të ndryshme".

Ai tha se ata që e kritikojnë fillimisht kanë thënë se nuk kishin dëgjuar asnjë zgjidhje dhe propozim prej tij, por sërish e sulmuan.

"Ju e shihni se çfarë hipokrizie e përgjithshme. Thoni se nuk e keni dëgjuar se çfarë përmban propozimin për Kosovën. Pajtohem, që nuk keni dëgjuar. Pse atëherë e

keni sulmuar propozimin. Shkaku i kësaj ma keni hequr kokën në mënyrë metaforike, por nuk keni dëgjuar as çfarë është. Tash kur them se dështoi, thoni se nuk e keni dëgjuar propozimin. Pse atëherë sulmuat dhe shkatërruat çdo gjë, pa dashur as të dëgjoni", pyeti Vuçiqi.

Ai shtoi se u organizua dialogu i brendshëm, por një pjesë e opozitës nuk ka paraqitur propozimin e saj për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

"Tash ju pyes juve cila është zgjidhja tani, përveç që Kosova në të ardhmen, jo me vullnetin tim, sepse unë nuk do ta pranoj, do ta fitojë pavarësinë dhe sovranitetin në tërë territorin e saj. Pastaj unë do të pyes shumë nga ata që protestuan dhe thanë shumë gjëra - pse e keni bërë këtë dhe si është e mundur që nuk keni qenë në gjendje të shikoni realitetin dhe keni penguar që Serbia të fitojë diçka për popullin dhe vendin e saj", ka thënë Vuçiqi.

## Papa viziton disa vende të Ballkanit

**PRISHTINË, 5 MAJ** - Papa Françesku u bëri të dielën thirrje udhëheqësve evropianë të zgjidhin problemin e pabarazisë së thellë ekonomike dhe rënien e ritmeve të lindjeve që kanë krijuar një "perde akulli" siç u shpreh ai, mes vendeve më të pasura dhe atyre më të varfra të Evropës. Ati i shenjtë tha se ky hendek po ushqen emigracionin. Papa i bëri komentet në Bullgari ku fil-

loi të dielën një vizitë dyditëshe. "Bullgaria po ndeshet me pasojat e emigracionit të dekadave të fundit. Mbi 2 milionë shtetas të saj janë larguar në kërkim të një jete më të mirë dhe të më shumë mundësive. Bullgaria duhet të merret gjithashtu edhe me një fenomen që do ta quaja "dimri i ri" - problemin demografik që ka rënë si perde akulli mbi një pjesë të madhe të Evropës dhe reflek-

ton rënien e besimit tek e ardhmja", tha ai.

Bullgaria, e cila u anëtarësua në Bashkimin Evropian në vitin 2007, është vendi më varfër i BE-së. Mbi dy milionë bullgarë janë larguar nga vendi që nga rënia e komunizmit.

Pas vizitës në Bullgari, Ati i shenjtë do të shkojë në Maqedoninë e Veriut, vendlindja e Nënë Terezës.



Sot (e hënë) fillon muaji i shenjtë i Ramazanit

# Myftiu Tërnavë bën thirrje për bashkim politik



Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të Ramazanit, i ka ftuar faktorët institucionalë që të bashkohen në dobi të atdheut dhe qytetarëve të Kosovës. Ai ka thënë se e kemi për obligim që brezit të ri t'i sigurojmë perspektivë në vendin tonë

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 MAJ - Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, ka uruar të gjithë besimtarët myslimanë për fillimin e muajit të shenjtë të Ramazanit. Me këtë rast, Tërnavë ka bërë thirrje për unitet politik dhe perspektivë më të dobishme për qytetarët e vendit. "Në prag të muajit të madhëruar të Ramazanit ftoj të gjithë faktorët tanë institu-

cionalë që ta ruajnë unitetin veprues në dobi të atdheut e qytetarëve tanë. Ftoj që të bëhet më shumë që shteti ynë të jetë vend ku mund të jetohet e punohet me dinjitet. E kemi për obligim që brezit të ri t'i sigurojmë perspektivë në vendin tonë e jo t'i bëjmë ata që të ikin nga vendi ynë në mungesë të perspektivës", ka thënë Tërnavë. Ai ka treguar se agjërimit është një prej pesë shtyllave kryesore të fesë islame të cilin e kanë trajtuar gjerësisht Kurani dhe

Syneti. "Nesër besimtarët myslimanët anekënd botës nisin agjërimitin e muajit të madhëruar të Ramazanit, këtij adhurimi njëmuajor, i cili për nga rëndësia, mësimet dhe objektivat është më shumë se thjesht një adhurim. Agjërimit është një prej pesë shtyllave kryesore të fesë sonë islame e të cilin e kanë trajtuar gjerësisht Kurani dhe Syneti. Andaj më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, t'ju drejtohem me përgëzimet më të mira, duke ju dëshiruar që këtë muaj ta përjetoni me të gjitha mirësitë e begatitë e tij", ka thënë Tërnavë.

Myftiu i Kosovës ka thënë se në këtë muaj besimtarët duhet t'i shtojnë lutjet dhe ibadetet ndaj Krijuesit. "Neve na ndajnë

vetëm edhe disa orë nga fillimi i agjërimit të muajit të Ramazanit, muajit të mëshirës, faljeve, lutjeve, reflektimit, pendimit dhe shpëtimit; muajit kur besimtarët shtojnë lutjet dhe ibadetet, rrisin ndjesinë e përkushtimit ndaj Krijuesit, ndaj shoqërisë e ndaj familjes. Po ashtu, rrisin ndjesinë e solidaritetit, ndihmës dhe bamirësisë; muajit në të cilin edhe lutjet drejtuar Zotit pranohen më shumë; muajit të mirësisë të panumërta", është shprehur ai, duke shtuar se agjërimit për besimtarët është një adhurim në vete. "Agjërimit për besimtarët është një adhurim që bartë në vete përkushtimin, vendosmërinë, bindjen, urtësinë, devotshmërinë, sinqeritetin, dashurinë, sakrificën, unitetin, tolerancën dhe mirëkuptimin, vlera këto

që e ekuilibrojnë njeriun, e fisnikërojnë shoqërinë, si dhe ndikojnë në reflektimin për hyjnoren, njerëzoren dhe humanen", është shprehur ai. Sipas Tërnavës, besimtari përmes agjërimit më së miri shpreh përkushtimin, bindjen dhe sinqeritetin e tij ndaj Krijuesit të Madhërisë. "Për këtë Allahu xh. sh. në Kuran thotë: 'Muaji i Ramazanit është ai në të cilin zbriti Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). Prandaj, kush e arrin prej jush këtë muaj, le të agjërojë....", ka thënë ai.

Më tej, i pari i BIK-ut ka treguar se pse ky muaj është i veçantë për besimtarët. "Ramazani është muaj me vlerë dhe rëndësi të veçantë për besimtarët myslimanë sepse në këtë muaj Allahu xh. sh. filloi zbritjen e Kuranit të Muhamedi a. s., libër udhëzues të cilit kemi nevojë në vazhdimësi t'i referohemi për çdo nevojë, ngaqë kështu e përshkruan Kurani: 'Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzojnë se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh (El-Isra, 9)', ka thënë Tërnavë.

Ai i ka ftuar të gjithë besimtarët që gjatë këtij muaji t'i shtojnë adhurimet, t'i shtojnë veprat e mira, të jenë solidarë e humanë, të jenë më socialë, më tolerantë e më mirëkuptues sesa gjatë muajve të tjerë. "Ramazani është muaji i mëshirës, rahmetit e solidaritetit, ndaj gjatë këtij muaji ju ftoj të lutemi që ky muaj i madh, posaçërisht me ibadetin e agjërimit, të jetë një reflektim për ndaljen e konflikteve, trazirave e gjakderdhjeve në vatrën e krizës, e njerëzimi të jetojë në paqe dhe lumturi", ka thënë Tërnavë.

## Shoqata 'Bereqeti' gjatë muajit të Ramazanit do të shpërndajë 5 000 pako ushqimore për 5 000 familje

PRISHTINË, 5 MAJ (ER) - Shoqata Humanitare 'Bereqeti', e cila operon në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, gjatë këtij muaji të bekuar të Ramazanit do të ndihmojë 5 000 familje të varfra dhe skamnore me nga 5 000 pako ushqimore. Kjo ndihmë është donacion nga Drejtoria e

Vakfëve të Republikës së Turqisë. Xheldin Fazliu nga Shoqata 'Bereqeti' ka thënë se shpërndarja e tyre bëhet nëpërmjet Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës si dhe në bashkëpunim me drejtoritë për mirëqenie sociale nëpër komuna të Kosovës.

Edhe në vitet e kaluara Drejtoria

e Vakfëve e Republikës së Turqisë ka sjellë ndihma me pako ushqimore që iu janë ndarë nevojtarëve nga Shoqata Humanitare Bereqeti. Po ashtu, janë ndihmuar edhe familje nevojtare nga komuna e Bujanovcit si dhe disa shoqata që trajtojnë personat me aftësi të kufizuara.



Flet për "Epokën e re", Skender Reçica

# Rritja e pagës minimale

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se ministria që drejton ka ndërmarrë reforma ligjore në fushën e marrëdhënies së punës, fushën pensionale, atë sociale dhe familjare, si dhe të aftësisë së kufizuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se niveli i lartë i papunësisë me shkallën rreth 30 për qind është një nga brengat më të mëdha të qeverisë. Reçica ka thënë se vetëm në vitin e kaluar kanë arritur të përfshijnë në punësim dhe aftësim profesional mbi 12 000 punëkërkues. Sa i përket një numri të madh të lëndimeve dhe vdekjeve në vendin e punës, Reçica ka thënë se MPMS-ja do të jetë e pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Ndërkaq ka theksuar se rritja e pagës minimale në vend është e domosdoshme dhe tejet e rëndësishme për shkak të rritjes së kostos jetësore në vend



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 MAJ -

**"Epoka e re":** Z. Reçica, ka kaluar kohë më shumë se një vit qëkur keni marrë postin e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sa keni arritur të gjeni zgjidhje për fushat të cilat janë të para-para të kryhen nga kjo ministri?

**Reçica:** Pasi kam marrë mandatin, në shtator të vitit 2017, kemi nisur identifikimin e fushave në të cilat është dashur ndërhyrje në aspektin legjislativ, po dhe në të ofrimit të shërbimeve. Ndryshimet ligjore kanë qenë të nevojshme në pothuajse të gjitha fushat që mbulojmë. Në MPMS vitin e kaluar kemi ndërmarrë reformë ligjore në fushën e marrëdhënies së punës, fushën pensionale, atë sociale dhe familjare, si dhe të aftësisë së

kufizuar. Reformat që kemi ndërmarrë dhe ndryshimet e nevojshme ligjore janë bërë duke marrë parasysh problemet për zbatimin e legjislacionit aktual në fushat e lartpërmendura. Ndryshimet e nevojshme dhe të domosdoshme janë bërë duke marrë për bazë rrethanat socio-ekonomike të vendit, duke traspozuar një sërë direktivash të Bashkimit Evropian në legjislacionin aktual të Kosovës, si dhe duke marrë për bazë praktikatat më të mira të vendeve të zhvilluara.

**"Epoka e re":** Gjatë kohës së fushatës partia në të cilën jeni dha premtime se çdo familje do të ketë të punësuar nga një anëtar. Sa keni arritur ta përmbushni këtë premtim?

**Reçica:** Niveli i lartë i papunësisë me shkallën rreth 30 për qind

është një nga brengat tona më të mëdha dhe që po e përcjell si shqetësim shtetin tonë tash e sa vite. Andaj, rritja e mundësive për punësim ka qenë një nga objektivat kryesore të Nismës Socialdemokrate dhe që nga marrja e mandatit është pikë programore e qeverisë dhe dikasterit që unë drejtoj. Rritja e mundësive në masa aktive të tregut të punës (vetëpunësim, subvencionim në pagë, trajnim në punë) si dhe fuqizimi dhe rritja e mundësive për aftësim profesional kanë qenë dy drejtimet kryesore ku ne jemi fokusuar. Është e rëndësishme të përmendim se vetëm në vitin e kaluar kemi arritur të përfshijmë në punësim dhe aftësim profesional mbi 12 000 punëkërkues, duke u dhënë mundësi posaçërisht të rinjve dhe grave, si dy kategori që prijnë në listat e të papunëve. Sa i

përket projektit "Çdo familje nga një të punësuar", projekt ky i lansuar nga kryetari i Nismës Socialdemokrate, z. Fatmir Limaj, e që ka të bëjë me kategorinë e dytë përfituese të skemës së ndihmës sociale, që bëjnë pjesë ato familje përfituese të asistencës sociale që, të paktën, kanë një anëtar të aftë për punë, ne bashkërisht me kryetarin Limaj, përkatësisht zëvendëskryeministrin e vendit, vitin e kaluar kemi nisur takimet në disa komuna të Kosovës me këto familje, ku kemi diskutuar për mundësinë e përfshirjes së tyre në masa aktive të tregut të punës dhe aftësim profesional. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë përfshirë në masa aktive të tregut të punës.

Sa i përket kategorisë së dytë të përfituesve të asistencës sociale, kjo kategori do të trajtohet në

reformën për asistencë sociale që ne e kemi ndërmarrë, ku parashihet të rishikohen kriteret për përfitim të asistencës dhe një prej këtyre kriterëve do të jetë që përfituesit do të lejohen të punojnë dhe të marrin asistencë sociale në të njëjtën kohë derisa ta përmirësojnë qëndrueshëm pozitën financiare të tyre.

**"Epoka e re":** Kohët e fundit kemi parë se ka pasur vdekje të punëtorëve në vendet e punës. Çfarë hapash konkretë keni ndërmarrë për avancimin e të drejtave të punëtorëve? A do të duhej që MPMS-ja të jetë aktive me vizita në vendpunishite të cilat nuk i përmbushin masat e sigurisë dhe shëndetit në punë?

**Reçica:** Situata e krijuar në sektorin e ndërtimit të lartë, me një numër të madh të lëndimeve e, fatkeqësisht, edhe të vdekjeve

# Është e domosdoshme

me Inspektoratin e Punës ndër-morëm një aksion që konsistoi me shtimin e inspektimeve në sektorin e ndërtimit të lartë, aty ku numri i aksidenteve dhe lëndimeve është më i madh. Në kuadër të këtij plani në nëntor të vitit të kaluar zbarkuam në Prishtinë pothuajse tërë kontingjentin e inspektorëve, me qëllim që të sigurohemi për respektim të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, të përcaktuara me legjislacionin aktual. Gjatë këtij aksioni u është pezulluar puna mbi 100 vendpunishteve të cilat nuk kanë respektuar masat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe brenda një kohe të shkurtër, shumica prej tyre kanë arritur t'i plotësojnë masat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ky aksion që ne e kemi ndërmarrë ka bërë që në sektorin e ndërtimit në Prishtinë të ndërrojnë pamja dhe pothuajse në secilën vendpunishte të respektohen masat për siguri dhe shëndet në punë. Ky aksion ka vazhduar dhe është duke u realizuar edhe në komuna të tjera.

Krahas këtij aksioni, edhe vitin e kaluar dhe para pak ditësh kemi lansuar fushata vetëdijësuese me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për respektim të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë. E kam potencuar disa herë dhe po e theksoj edhe në këtë intervistë, do të jemi të pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat e sigurisë dhe të shëndetit të përcaktuara me ligjet në fuqi, andaj ftoj punëdhënësit, ashtu edhe punëmarrësit, t'i respektojnë këto masa në mënyrë që t'i shmangim lëndimet dhe vdekjet në vendin e punës.

**"Epoka e re":** Në fushën e marrëdhënies së punës, sfidë mbetet trajtimi jo i barabartë i personave me aftësi të kufizuara, pastaj financimi dhe ndarja e përgjegjë-sive për shërbime sociale dhe familjare, si dhe rreth skemave pensionale të financuara nga shteti. Sa keni arritur të ndryshoni diçka në këto tema?

**Reçica:** Siç përmenda krejt në fillim të kësaj interviste, në vitin e kaluar kemi nisur reformat në pothuajse të gjitha fushat, përfshirë atë pensionale, sociale dhe familjare, si dhe të aftësisë së kufizuar. Duke parë problemet e sistemit aktual pensional, me një mori ligjesh që rregullojnë të drejtat e përfituesve dhe në mungesë të një ligji bazik, shoqëruar me probleme të tjera rreth përfitimit të së drejtës në pension me të cilat ballafaqohen pensionistët tanë, në vitin e kaluar kemi hartuar koncept-dokumentin për reformë të sistemit pensional i cili është miratuar nga qeveria e vendit. Sa i përket reformës pensionale, tashmë

kemi një situatë të re ngaqë Kuvendi i Kosovës ka krijuar një komision ad-hoc i cili është mandatuar të krijojë kodin e ri pensional. Si ministër, unë jam ftuar në takim nga ky komision, në të cilin takim kam kërkuar nga komisioni përkatës që ta marrë për bazë koncept-dokumentin e hartuar nga MPMS-ja, i cili u përshtatet më së miri rrethanave socio-ekonomike dhe i cili është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë ndërkom-bëtarë. Komisionit, gjithashtu, ia kam ofruar gatishmërinë e plotë të stafit të MPMS-së për të ndihmuar në hartimin e kodit të ri pensional.

Sa i përket fushës sociale dhe familjare, me qëllim të ndarjes së duhur të përgjegjësisë, qartësimi të formave të financimit dhe avancimit në përgjithësi të shërbimeve sociale dhe familjare, ne kemi hartuar koncept-dokumentin për fushën sociale dhe familjare dhe në plan të punës për këtë vit kemi hartimin e Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare për të cilin grupet tona punuese janë duke punuar. Kategorizimi i drejtë dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara ka qenë sfidues tash e një kohë dhe ne kemi konsideruar të domosdoshme që të ndërmarrim veprime konkrete edhe në fushën e aftësisë së kufizuar. Vitin e kaluar ne kemi hartuar koncept-dokumentin për trajtimin dhe kategorizimin e personave me aftësi të kufizuara i cili është miratuar nga qeveria e vendit dhe këtë vit në plan legjislativ kemi hartimin e Projektligjit për Persona me Aftësi të Kufizuara i cili do të sigurojë trajtim të barabartë të të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara si dhe kategorizim të drejtë.

**"Epoka e re":** Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me organizatat e ndryshme, si ajo me GIZ-in, ka hapur panairë të punës. Panairët e tilla sa kanë arritur ta zbusin papunësinë në vend? Si dhe a keni arritur të bëni ndonjë marrëveshje si ministri me vende të ndryshme për t'u ofruar punëtorë nga Kosova?

**Reçica:** Para pak ditësh ne hapëm në Prishtinë Panairin Nacional të Punës dhe Karrierës, i cili erdhi pas organizimit të panairëve të punës në nivel lokal në shtatë qendrat rajonale, në bashkëpunim me Qeverinë e Gjermanisë, nëpërmjet GIZ-it. Kam qenë në hapje të pothuajse të gjitha këtyre panairëve dhe vazhdimisht kam vënë theksin në atë se panairët e tilla janë një mundësi e jashtëzakonshme si për punëdhënësit, që të takojnë fuqinë punëtore që iu nevojitet si

dhe për punëmarrësit, që ta takojnë punëdhënësin e tyre potencial dhe të bëhen pjesë e tregut të punës. Gjatë vizitave në këto panairë kam takuar shumë punëdhënësit të interesuar për punëtorë si dhe interesim të punëtorëve për t'i vizituar këto panairë dhe për t'u njohur me mundësitë për punësim. Panairët e tilla janë të rëndësishme dhe në shërbim të gjithsecilit punëmarrës dhe punëdhënësi dhe një pikë takimi që lehtëson mundësinë për t'u bërë pjesë e tregut të punës për punëkërkuarët si dhe për t'i gjetur punëtorët e kualifikuar për punëdhënësit e interesuar. Sa iu përket marrëveshjeve për punësim sezonal në vendet e Bashkimit Evropian, Kosova aktualisht nuk ka një marrëveshje të tillë me asnjë shtet. Në shumë nga takimet që kam pasur me përfaqësues diplomatikë të shteteve të huaja në Kosovë, por edhe në vizitat zyrtare që kam pasur në shtete të BE-së, kemi diskutuar mundësinë për lidhjen e marrëveshjeve për punësim sezonal, si një mundësi e mirë për qytetarët tanë që nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale ta kenë mundësinë e punësimit sezonal në vendet e BE-së.

**"Epoka e re":** Jeni deklaruar edhe për rritje të pagës minimale. Sipas jush, sa ka kapacitete buxhetore për këtë?

**Reçica:** Menjëherë pas marrjes së mandatit në vitin 2017 kemi rifunksionalizuar Këshillin Ekonomiko-Social dhe kemi funksionalizuar komisionet profesionale. Ndër temat e para të trajtuara në KES ka qenë paga minimale. Në fund të vitit 2017, KES ka nxjerrë propozimin për rritje të pagës minimale në vlerë 250 euro, propozim të cilin ia kemi dërguar për miratim qeverisë në janar të vitit 2018, por që nuk është vënë asnjëherë në rend ditë për miratim nga qeveria dhe rrjedhimisht nuk është miratuar nga qeveria. Pak ditë më parë, bazuar në Ligjin për KES-in, ne kemi konstituar KES-in me anëtarë të rinj, ku edhe kemi mbajtur mbledhjen e parë pas konstituimit. Së shpejti ne do ta kemi për diskutim edhe rritjen e pagës minimale, ku do të dalim me një propozim të ri. Natyrisht se gjatë nxjerrjes së propozimit të ri për pagë minimale do të merren për bazë kriteret e përcaktuara me ligj sa i përket caktimit të pagës minimale dhe natyrisht duhet të nxirret propozim që do të jetë i përbalueshëm nga buxheti i Republikës së Kosovës. Megjithatë, rithekoj se rritja e pagës minimale në vend është e domosdoshme dhe tejet e rëndësishme për shkak të rritjes së kostonetës në vend. Mos të harrojmë të përmendim se që

nga viti 2011 nuk ka pasur asnjë propozim për rritje të pagës minimale, përkatësisht as rritje të pagës minimale deri në vitin 2017-n, ku ne si KES kemi propozuar rritje të pagës minimale.

**"Epoka e re":** Rritja e pagës minimale, a mund të jetë shkas për pakënaqësi të pensioneve të veteranëve?

**Reçica:** Sa iu përket pensioneve të financuara nga shteti dhe të cilat menaxhohen nga MPMS-ja dhe ndërlidhjes së tyre me propozimin që KES ka nxjerrë në fund të vitit 2017 për rritje të pagës minimale, ka pasur hezitime se ky propozim mund t'i afektojë skemat pensionale. Para se KES ta nxjerrë propozimin për pagë minimale në fund të vitit 2017 dhe t'ia përcjellë qeverisë për miratim, ka konsultuar këtë propozim me zyrtarët ligjorë të MPMS-së, por edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe opinionin ligjor që ne kemi marrë nga të dyja zyrat ligjore është se ky propozim nuk prek asnjëherë prej skemave pensionale të financuara nga shteti dhe të menaxhuara nga MPMS-ja.

**"Epoka e re":** Meqenëse pushimi i lehonisë mbeti jashtë Projektligjit të Punës, si parashihni ta zgjidhni këtë çështje dhe deri ku keni shkuar me punët në këtë drejtim?

**Reçica:** Vitin e kaluar kemi hartuar Projektligjin e ri të Punës dhe Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Pushimin Prindëror, të dyja projektligje këto që kanë buruar nga koncept-dokumenti për rregullimin e fushës së marrëdhënies së punës. Vlen të theksohet se për herë të parë është hartuar një projektligj i veçantë që do t'i rregullojë të drejtat e nënave lehonë si dhe për herë të parë është përfshirë edhe pushimi prindëror, si e drejtë e garantuar edhe e nënës edhe e babait. Projektligji i Punës tashmë është shqyrtuar në lexim të parë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërkaq Kuvendi së shpejti do ta ketë për miratim edhe Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror, i cili do ta plotësojë fushën e marrëdhënies së punës.

**"Epoka e re":** Sa është numri i personave që kanë aplikuar për njohjen e statusit të dhunës seksuale gjatë luftës?

**Reçica:** Deri më tani Komisioni Qeveritar për Verifikim dhe Njohje të Statusit të të Dhunuarve gjatë luftës së fundit në Kosovë ka pranuar 1 002 kërkesa, prej tyre janë aprovuar 336, janë refuzua 130, në proces janë 44, ndërkaq në pritje për trajtim janë 492.



në vendin e punës, përbën shqetësim për ne. Me përgjegjësi të plotë them se nuk kemi qëndruar duarkryq përballë kësaj situatë. Kemi shtuar përpjekjet për rritje të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës nëpërmjet ndërmarrjes së një sërë veprimesh konkrete. Ndër veprimet e para ka qenë krijimi i një baze të re ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, nëpërmjet transpozimit të një sërë direktivave të BE-së, nëpërmjet hartimit të Projektligjit të ri të punës i cili është shqyrtuar në lexim të parë në Kuvend, hartimit të Projektligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror, si dhe plotësim-ndryshimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës, i cili ka kaluar në lexim të parë në Kuvend.

Krahas këtyre ndryshimeve ligjore, në vitin e kaluar bashkë

## Thaçi e Haradinaj nderojnë dëshmorët e Pejës

PEJË, 5 MAJ (ER) - Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të dielën në tubimin përkujtimor me rastin e 5 Majit - Ditës së Dëshmorëve të Kombit, në nderim të 183 dëshmorëve të Komunës së Pejës, që u organizua nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës. Fillimisht presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë homazhe të pllaka përkujtimore e dëshmorëve të kombit të Komunës së Pejës dhe të shtatorja

e heroit të kombit, Shkëlzen Haradinaj. Pas homazheve, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se është nder i madh për të gjithë që ta respektojnë këtë ditë historike për kombin, Ditën e Dëshmorëve. "Sot nderojmë dëshmorët e Pejës me rrethinë dhe gjithë dëshmorët që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Jam i bindur se shteti ynë është në rrugë të drejtë. Askush nuk është i përkryer, por jemi duke e bërë punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Kujtojmë sot edhe

genocidin që shteti i Serbisë ka kryer në Kosovë duke vrarë rreth 13 500 civilë, mbi 800 masakra e rreth 20 mijë dhunime. Fjalët e kongresistit Eliot Engel, në Kongresin Amerikan, ishin shprehë për ne për të kërkuar më shumë drejtësi për gjithë këto viktima", ka deklaruar Thaçi. Kryeministri Haradinaj, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha se vlera e lirisë duhet të jetë e respektuar ashtu siç i takon. Më tej, kryeministri Haradinaj ka thënë se gjatë vitit 1999, kur është kthyer në

Pejë, ka parë vetëm shkrumb e hi, por që era i vinte liri. "Në vitin 1999, në qershor, kur kam ardhur këtu, e kam parë Pejën shkrumb e hi, veç era i vinte liri. Era e shkrumbit, e djegies e krejt shkatërrimeve nuk ndihej, por ndihej era e lirisë. Është një dallim i një Peje çfarë e ka synuar pushtuesi atëherë e të një Peje çfarë e ka krijuar liria. Pushtuesi ka pasur qëllim ta bëjë Pejën bazë të vetën të fortë, për një pikë që na mban në kontroll gjatë e përherë, po bijtë dhe bijat juaja të Pejës, të rrafshit e të Rugovës, e

kanë ndryshuar në qershor të '99-s", ka thënë Haradinaj, i cili për lirinë e vendit tonë i është falënderuar ShBA-së dhe NATO-s. "Historia na ka mësuar. Po ashtu, kur jemi të vendosur, kur e kemi qëllimin e drejtë, na ndihmon edhe Zoti. Na ndihmoi Zoti, NATO-ja, Amerika dhe u çliruam. Sot jemi të lirë. Sot jemi në Pejën tonë. Unë sa herë që në vij në Pejë, qoftë për përvjetor, qoftë për qejf, kurrë nuk më hiqet prej mendje pamja që e kam parë prej këtij ballkoni këtu", ka thënë kryeministri Haradinaj.



## Agim Bahtiri rizgjedhet kryetar i Degës së AKR-së në Mitrovicë

Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR) në Mitrovicë, Agim Bahtiri, ka thënë se AKR-ja vazhdon t'i mbrojtë vlerat liberale, ku interesi i qytetarëve dhe transparenca do të jenë prioritete edhe në të ardhmen. Ai i ka falënderuar delegatët për përkrahjen dhe punën e palodhshme, duke u bërë thirrje të dëshmojnë edhe një herë që puna dhe kontributi i AKR-së janë të duhurat për Mitrovicën

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

MITROVICË, 5 MAJ - Në prani të 500 delegatëve dhe mysafirëve të shumtë, të dielën Aleanca Kosova e Re (AKR) ka mbajtur Konventën e Pestë Zgjedhore të degës së vet në Mitrovicë. Në këtë kuvend Agim Bahtiri me shumicë votash është rizgjedhur kryetar i Degës së AKR-së në Mitrovicë edhe për një mandat. Po ashtu, u konfirmuan edhe 71 delegatë, nga të cilët do të formohet Kryesia e Degës së AKR-së. Kryetari i AKR-së në Mitrovicë,

Agim Bahtiri, duke i falënderuar delegatët për përkrahjen dhe punën e palodhshme, u bëri thirrje të gjithëve që ta dëshmojnë edhe një herë se puna dhe kontributi i AKR-së janë të duhurat për Mitrovicën. "Po punojmë me duar të pastra, me ndërjegje të plotë për të ofruar mirëqenie për të gjithë qytetarët e Mitrovicës pa dallim", është shprehur Bahtiri. Ai përmendi disa prej investimeve të mëdha që janë bërë në Mitrovicë gjatë mandatit të AKR-së. Ai ka shtuar se Aleanca Kosova e Re vazhdon t'i mbrojtë vlerat liberale ku interesi i qytetarëve dhe trans-



parenca do të jenë prioritete edhe në të ardhmen. Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka thënë se partia të cilën e udhëheq është në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Duke e falënderuar kryetarin e Mitrovicës nga radhët e AKR-së, Agim Bahtiri, Pacolli ka thënë se qeverisja e AKR-së në Mitrovicë, në krye me Bahtirin, u ka shërbyer me dinjitet qytetarëve të Mitrovicës.

"Mitrovica po lulëzon falë vullnetit të mirë të tij", është shprehur Pacolli, duke vlerësuar projektet dhe nismat të cilat janë realizuar përmes punës së palodhshme të të parit të Mitrovicës.

Është mbajtur mbledhja e 37 e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje

## Kurti kërkon mobilizim për zgjedhje të reja

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se ka ardhur koha për një qeveri të re e cila do t'ua kthejë qytetarëve besimin në shtet. Ai të dielën ka kërkuar mobilizim nga anëtarësia për zgjedhje të reja. Në mbledhjen e 37 të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Kurti ka folur edhe për bisedimet me Serbinë, duke thënë se Kosova nuk mund të bëjë normalizim të marrëdhënieve me të tjerët përderisa shteti është për-tokë dhe korrupsioni në kulm

tradhtuar qytetarin e Kosovës. Nevojitet qeveri e re që nuk vjedh, e që ia kthen besimin qytetarit në shtet. Sepse këta udhëheqës institucionesh ia kanë hequr udhën shtetit. Me asfalt pa hesap e me hesap nepotizmi. Pse është pa punë rinia? Sepse po vjedh qeveria. Ajo po vjedh në të tashmen, por ajo po e vjedh edhe të ardhmen", është shprehur Kurti. Ai ka thënë se hajnat janë bërë bashkë në PAN, pikërisht sepse janë në panik. "Shahen ditë e natë, por rrinë bashkë, sepse ndihen të pasigurt", ka theksuar ai. Para anëtarësisë Kurti ka folur edhe për bisedimet me Serbinë, duke thënë se Kosova nuk mund të bëjë normalizim të marrëdhënieve me të tjerët përderisa shteti është për-tokë dhe korrupsioni qeveritar në kulm. Ai ka theksuar se kryeministri Haradinaj nuk po qëndron pse beson në taksën 100 për qind, por pse e do pushtetin. "E ka kuptuar, e ka hetuar që, po e hoqi taksën,

do ta heqin nga pushteti, prandaj po e zgjat sa po mundet qëndrimin në pushtet që t'i japë kohë ministrit të asfaltit, Pal Lekaj", ka thënë Kurti, duke shtuar se Haradinaj në marsin e vitit të kaluar, në vend se të zgjedhte territorin e shtetit, pati zgjedhur karrigen e pushtetit. "Ky kryeministër e dorëzoi shtetin e Kosovës te gabimi i Murat Mehës dhe tha se më vonë do ta korrigjojë këtë. Nuk kishte korrigjim sepse ai ishte mashtrim. Me këta njerëz, secila ditë e lume është 1 prill i zi", ka deklaruar Kurti. Më tutje, ai ka folur edhe për përkushtimin e qeverisë që buxheti të orientohet për asfalt e jo për ushtri dhe zhvillim. Kurti ka thënë se Kosova nuk ecën drejt BE-së duke hequr tokë të shtetit, por duke u hequr prej pushtetit pushtetarët. "Serbia shpenzon për ushtri më shumë sesa të gjitha pesë shtetet e tjera të Ballkanit perëndimor marrë së bashku. Në anën tjetër, krerët institucionalë të Kosovës kërkojnë nga BE-ja

veçse liberalizim të vizave, ndërkaq buxheti i vendit tonë është i rezervuar për asfalt tekta FSK-së i kanë ngelur ato tri ligjet e reja në letër. Është e dëmshme për dinjitetin e qytetarit të Kosovës kur kryeministri, presidenti e kryeparlamentari, kërkojnë veçse liberalizim të vizave. Le ta bëjë këtë kërkesë ministria e Integritimit Evropian. Edhe ashtu të gjithë këta janë mashtrues e gënjeshtarë. Për liberalizim të vizave këta ia hoqën shtetit të Kosovës 8 200 hektarë, por këta nuk po duan ta kuptojnë atë që tashmë e dinë: nuk ecim drejt BE-së duke hequr tokë të shtetit, por duke u hequr prej pushtetit këta që po ia heqin tokën, buxhetin dhe pasuritë vendit tonë", ka thënë Kurti. Para të pranishmëve ai ka folur edhe për zgjedhjet lokale në veri të cilat do të mbahen më 19 maj. Kurti ka thënë se alternativa më e mirë në këto zgjedhje janë kandidatët e Vetëvendosjes.

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të dielën ka paralajmëruar vazhdimin e takimeve me qytetarë nëpër komuna në kuadër të fushatës kundër 'PANhajnisë'. Sipas tij, përgjatë kësaj fushate janë rritur shumë anëtarësimet e reja në Vetëvendosje. "Ne nuk e pranojmë korrupsionin, ne nuk e durojmë korrupsionin, andaj sot në opozitë ne nuk heshtim dhe veprojmë kundër korrupsionit, ndërkaq nesër në qeveri do ta ndalim dhe ndalojmë. Përgjatë fushatës kundër PANhajnisë janë rritur shumë anëtarësimet e reja në Lëvizjen Vetëvendosje. Muaji me më së shumti anëtarësime të reja në këtë vit është muaji prill. E tash muaji maj do të jetë muaj edhe me më shumë anëtarësime sesa prilli. Ju faleminderit edhe një herë që po e rrisni e forconi Vetëvendosjen, që po e zgjeroni e po e thelloni Lëvizjen", ka deklaruar Kurti në mbledhjen e 37 të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kurti ka kërkuar mobilizim të anëtarëve për mbajtjen e zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme. "Nga lotët e zisë e të krenarisë, në 20-vjetorin e pranverës 1999, duhet të kalojmë te entuziazmi e shpresa për 20 vjetët e ardhshëm. Duke filluar me zgjedhje të reja për qeveri të re, për qeverisje të re, për kohë të re. Pa hajna në qeveri, pa nazim sahita në polici, pa lepurusha në prokurori, pa monopole në ekonomi, me prodhim e



## Kryeziu: LDK-ja dhe LV-ja duhet të jenë pjesë e dialogut me Serbinë



PRISHTINË, 5 MAJ - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se është shumë e rëndësishme që Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) t'i bashkohet grupit negociator për dialogun me Serbinë. Sipas tij, LDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje duhet ta gjejnë mënyrën dhe fuqinë për të qenë pjesë e ekipit dhe dialogut. Kryeziu në një intervistë dhënë për "KosovaPress" ka thënë se

me tërheqjen e kryeministrit Haradinaj nga pjesëmarrja në dialog dhe me debatin e presidentit për korrigjimin e kufijve, klasa politike e ka kthyer vëmendjen te kjo çështje dhe është formuar grupi negociator i cili i ka marrë votat e Kuvendit të Kosovës.

Kryeziu konsideron se Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje duhet të jenë pjesë e ekipit. "Opozita duhet ta gjejë mënyrën dhe

fuqinë për të qenë pjesë e këtij grupi dhe për t'u futur në dialogun me Serbinë, i cili adresuar edhe në letërnënqë e ka bërë presidenti Trump dhe zhvillimet e tjera, ndoshta do ta kishte si pikë përfundimtare vitin 2019, nëse do të mundnim ta përmblyllim do të kishte qenë më mirë për qytetarët e Kosovës, për rajonin dhe për shërbimet politike të brendshme gjithsesi", ka thënë Kryeziu.

# Veseli takon shoqatat e të pagjeturve: Tribunali për kriminelët serbë do të ndodhë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar shoqatat e personave të pagjetur që janë vrarë dhe zhdukur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe gjatë luftës në Kosovë më 1998-1999.

Kreu i Kuvendit ka thënë se pas dështimit të Gjykatës së Hagës dhe institucioneve të tjera për dënimin e krimeve serbe në Kosovë, institucionet e Kosovës e kanë obligim nisjen për formimin e një tribunali ndërkombëtar për gjykimin e kriminelëve serbë. "Shoqatat e të pagjeturve janë më të prekurat

nga gjenocidi serb i kryer në Kosovë, njëkohësisht më aktivet e më të angazhuarat për kërkimin dhe vulosjen e drejtësisë. Ne si institucione të Republikës së Kosovës kemi për obligim ta mbrojmë jo vetëm lirinë, shtetin dhe jetën e qytetarëve tanë, por edhe të vërtetën e luftës sonë çlirimtare. Krimet dhe masakrat e kryera nga Serbia në Kosovë janë të përmasave të gjenocidit. Ne kemi besuar se drejtësia ndërkombëtare do ta thotë fjalën e vet për dënimin e këtyre krimeve. Fatkeqësisht, kanë kaluar dy dekada dhe pak ose aspak nuk është bërë në këtë drejtim. Tribunali i Hagës i ka lënë në gjysmë proceset gjyqësore kundër krerëve të regjimit të



Milosheviqit. Ndërkaq, Serbia është munduar ta mbyllë këtë punë duke organizuar gjykime të rrejshme të oficerëve të saj që kanë marrë pjesë në masakrat e

kryera në Kosovë. Kjo është e papranueshme", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se 186 masakra të kryera në Kosovë kërkojnë drejtësi. "Heshtja ndaj dëshmitëve

dhe dëshmitarëve është falje e heshtur për kriminelët. Kjo nuk bën të ndodhë. Dhe nuk do të ndalemi derisa ta arrijmë qëllimin tonë", ka deklaruar Veseli.

## Suedia përkrah Kosovën në procesin e integritetit evropian

PRISHTINË 5 MAJ (ER) - Zëvendësministri i Integritetit Evropian, Lirak Çelaj, me bashkëpunëtorë, në vizitën zyrtare në Suedi, është pritur në Sekretariatit Koordinues për Bashkimin Evropian, pranë Zyrës së Kryeministrit të Suedisë, ku takoi Jan Olsson, me të cilin ka diskutuar për procesin integruar, me fokus në liberalizimin e vizave.

Çelaj vuri në dukje përkushtimin e institucioneve qendrore dhe lokale për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, Agjendën Evropiane të Reformave si dhe pritshmëritë e qytetarëve tanë pas plotësimit të të gjitha kriterëve për liberalizim nga udhërrëfyesi. "Suedia ka qenë përkrahëse e Kosovës në të



gjitha proceset dhe sfidat, si para luftës kur priti shumë bashkë atdhetarë tanë, ashtu edhe gjatë luftës dhe pasluftës për ndërtimin e shtetit tonë. Suedia edhe sot e përkrah Republikën e Kosovës nëpërmjet organizatave

humanitare dhe fondeve të drejtpërdrejta, duke fuqizuar institucionet e Kosovës, demokratizimin si dhe të drejtë e njeriut", ka deklaruar Çelaj, duke shtuar se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe më tej në

mbledhjen e Këshillit të Ministrave si dhe në kandidaturën e ardhshme të Kosovës për statusin e kandidates për anëtarësim në BE.

Olsson rikonfirmoi përkrahjen e Suedisë për Kosovën në proceset dhe sfidat aktuale, duke vënë theksin jo vetëm për liberalizimin e vizave, por edhe për fuqizimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit si dhe sektorët e tjerë të rëndësishëm për institucionet e Kosovës.

Çelaj pati takim edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku u prit nga Anna-Karin Enestrom, drejtoreshë për Çështjet Politike si dhe në Ministrinë e Drejtësisë, ku u prit në takim nga Anna-Carin Svensson, drejtore-

shë e Përgjithshme për Çështjet Ndërkombëtare. "Kosova ka nevojë për përkrahje në proceset tejet të rëndësishme për qytetarët si liberalizimi i vizave, integrimi në organizatat ndërkombëtare si dhe zbatimi i MSA-së dhe reformat e tjera që përafrojnë Kosovën me BE-në", ka thënë Çelaj, duke shtuar se me miqtë dhe përkrahjen që vjen nga Suedia, këto sfida për Kosovën janë më lehtë të zgjidhshme. Ai ka theksuar se mosangazhimi i mjaftueshëm i BE-së në Kosovë dhe rajon në përgjithësi rrezikon që Ballkani Perëndimor të shndërrohet në rajon ku mund të shtrihen ndikimet e disa vendeve të tjera e që nuk do të ishte mirë jo vetëm për rajonin, por edhe për vetë BE-në.

## SBASHK-u ofron kompensim 'me kusht' vetëm një javë për orët e humbura

PRISHTINË, 5 MAJ - Më 26 shkurt Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës (MASHT) kishte marrë vendim për kompensim të orëve të humbura mësimore, gjatë grevës trejavëshe të mësimdhënësve, nga gjysma e dytë e janarit deri në fund të javës së parë të muajit shkurt.

Në vendimin e MASHT-it thuhej se "ditët e humbura të mësimin në institucionet e arsimit parauniversitar do të zëvendësohen, fillimisht me pesë ditë të marra nga pushimi pranveror në prill të këtij viti, pesë ditë të shtuna dhe pesë ditë do të zgjatet përfundimi i këtij viti shkollor". Por, ky vendim i Ministrisë së Arsimit nuk u respektua nga



Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkencës e Kosovës (SBASHK-u), e cila i bindi mësimdhënësit që të mos i kompensojnë orët e humbura as gjatë pushimit pranveror e as të shtunave. Kjo sindikatë mbetet prapa qëndrimit të vet fillestar, se nuk do të ketë kompensim të orëve. Megjithatë, ajo ka vënë një kusht për kompensim të orëve të

humbura, vetëm për një javë, në rast se Kuvendi i Kosovës mbledhet në një seancë të jashtëzakonshme dhe përmes një ndryshim-plotësimi të Ligjit për Pagat barazon koeficientin e mësimdhënësve të ciklit klasor një deri në pesë, të pedagogëve, të psikologëve dhe të sekretarëve me atë të mësimdhënësve të ciklit klasor gjashtë deri në nëntë. Sipas kreut të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, asnjë ligj e as konventë ndërkombëtare nuk i obligon ata t'i kompensojnë orët e humbura gjatë grevës dhe se "përfundimin për zëvendësim të orëve të humbura, për një javë" do ta bënin vetëm për hir të kolegëve që janë dëmtuar nga koeficienti. (REL)

## KFOR-i mban stërvitje, thotë se situata në Kosovë është nën kontroll

PRISHTINË, 5 MAJ (ER) - Trupat ushtarake të NATO-s, të pozicionuara në Kosovë, do t'i vazhdojnë stërvitjet në disa pjesë të ndryshme të Kosovës. Kjo është bërë me dije në faqen zyrtare të KFOR-it në "Facebook", ku theksohet se kjo është vetëm një stërvitje normale e zbakimit dhe procedurave. Sipas tyre, situata mbetet nën kontroll dhe pa asnjë kërcënim të mundshëm. "KFOR-i vazhdon të stërvitet për të qenë i gatshëm dhe të garantojë siguri për të gjithë njerëzit në Kosovë.



Në ditët e ardhshme do të ketë disa lëvizje të trupave të KFOR-it në pjesë të ndryshme të Kosovës. Kjo është vetëm një stërvitje normale e zbakimit dhe procedurave. Situata mbetet nën kontroll, pa asnjë shenjë kërcënimi të mundshëm", thuhet në njoftimin e KFOR-it.



# Rritja e pagës minimale sfidon sektorin privat

Paga minimale në Kosovë, ndonëse sipas Ligjit të punës do të duhej të përcaktohej çdo vit, që nga viti 2011 vazhdon të jetë 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç

**PRISHTINË, 5 MAJ** - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që paga minimale në Kosovë të jetë 300 euro në muaj dhe jo 250 sa është kërkuar para dy vjetësh. Kjo kërkesë nga kryetari i BSPK-së, Avni Arifi, është bërë më 1 Maj, në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve.

Për shkak të rritjes së çmimit të shportës bazë të qytetarit, ka thënë ai, është rritur edhe kërkesa e tyre për pagën minimale, nga 250 në 300 euro. Paga minimale në Kosovë, ndonëse sipas Ligjit të punës do të duhej të përcaktohej çdo vit, që nga viti 2011 vazhdon të jetë 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç.

Këshilli Ekonomik-Social, i cili

përfshin përfaqësuesit e punëtorëve, bizneseve dhe institucionet e vendit, qysh në vitin 2017 kishte propozuar që paga minimale të rritet, mirëpo propozimet e dhëna deri më tani nuk kanë hyrë në fuqi.

Se rritja e pagës minimale është e domosdoshme thotë edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, por nuk përmend ndonjë shumë të caktuar. Reçica në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka treguar se në vitin 2017 nga Këshilli Ekonomik Social është propozuar që paga minimale të jetë 250 euro në muaj, propozim ky që në atë kohë është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës, por që nuk është miratuar.

Aktualisht ministri Reçica thotë se është në pritje të merret ndonjë vendim nga Këshilli

Ekonomik Social për nivelin e pagës minimale në vend. "Nuk mund të them sot sa mund të jetë reale, 220-250 apo 300, sepse janë disa kritere që realisht përcaktojnë mënyrën se si mund të vihet deri te propozimi për pagën minimale. Unë, personalisht, nuk jam i kënaqur me vlerën e pagës minimale prej 250 eurosh. Por, ne duhet të mësohemi që të nxjerrim vendime dhe propozime të cilat mund t'i përballojë edhe sistemi buxhetor fiskal i vendit. Dhe, nuk mund t'i jap liri vetes të them se e ka mirë apo keq BSPK-ja në këtë drejtim. Unë mendoj se rekomandimi që nxirret për pagën minimale duhet të jetë i bazuar", ka thënë Reçica.

Edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit konsiderojnë se kërkesa për rritjen e pagës minimale në Kosovë është në kundërshtim me gjendjen ekonomike sociale. Berat Rukiqi, kryetar në Odën Ekonomike të Kosovës, i cili njëherësh është edhe përfaqësues në Këshillin Ekonomik Social, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kërkesa e BSPK-së është vështirë e

realizueshme edhe pse, sipas tij, punëdhënësit në sektorin privat janë të gatshëm të paguajnë këtë vlerë të pagës. "Nëse kushtet ekonomike do të ishin më të mira, vlera do të duhej të ishte edhe më e lartë. Mirëpo, në rrethanat që jemi ne, nuk mund të dalim jashtë vendeve të rajonit dhe indikatorëve makroekonomikë që i kemi. Nuk besoj se kjo është problematikë për shumicën e sektorëve", ka theksuar Rukiqi.

Ali Dragusha, ish-përfaqësues i sindikatave të punëtorëve, ka thënë se kërkesa për rritjen e pagës minimale është e pamenduar dhe vlerësuar mirë. Ai ka shtuar se vlera duhet të jetë e arsyeshme edhe për institucionet qeveritare, sindikatën, por edhe për punëdhënësit. "Në formën qysh është kërkuar nga BSPK-ja, unë mendoj se kjo krijon kundërefekte dhe është shumë vështirë që të pajtohen edhe Qeveria, edhe punëdhënësit. Duhet të jemi të arsyeshëm, të bëhet një vlerësim i arsyeshëm, të jepet një propozim i arsyeshëm për ta finalizuar bashkërisht përmes Këshillit Ekonomik Social, në

mënyrë që ajo vlerë të realizohet", ka vlerësuar Dragusha.

Ai dyshon se punëdhënësit në sektorin privat mund të realizojnë një pagë të tillë, sidomos kur dihet se në këtë sektor, sipas tij, shumë punëtorë nuk kanë kontrata të punës, pasi punëdhënësit nuk i paraqesin ata për t'u ikur pagesave dhe kontributeve për shtetin. "Në sektorin privat, në të gjitha format shkelen të drejtat e punëtorëve. Kështu që është shumë vështirë që ky sektor ta zbatojë çfarëdo page minimale që përcaktohet nga Këshilli Ekonomik Social, sepse kemi mangësi dhe neglizhencë edhe nga Inspektorati i Punës, kemi mangësi dhe neglizhencë edhe në gjykata", ka thënë Dragusha. Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në muajin mars ka kërkuar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe palët e tjera të përfshira në këtë proces, që të diskutohet për pagën minimale. Ai ka thënë se e përkrah çdo rekomandim të Këshillit Ekonomik Social për rritje të pagës minimale e cila nuk ka pësuar rritje që nga viti 2011.



## Taksa ndikoi në rritje të prodhimit

**PRISHTINË, 5 MAJ** - Prodhuesit kërkojnë që edhe më tej vendimi i qeverisë për taksën ndaj Serbisë të jetë në fuqi sepse ka ndikuar në rritje të prodhimit, eksportit dhe punësimit në vend. Përfaqësuesi i kompanisë "Pestova-Vipa" bën thirrje që kryeministri Ramush Haradinaj të mos heqë dorë nga taksa që u është vënë produkteve serbe dhe boshnjake, duke thënë se kështu po fuqizohen prodhuesit vendorë.

Drejtori i shitjes në këtë kompani,

Fatos Kastrati, ka thënë për "KosovaPress" se prodhuesit vendorë janë ata që po përfitojnë më së shumti nga taksa e vendosur për produktet që importohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kastrati thotë se pas vendosjes së taksës si kompani është dashur ta shtojnë prodhimin.

Ndonëse në bazë të disa statistikave zyrtare, pas kësaj takse ka pasur një ngritje të lehtë të çmimeve për produktet, Kastrati ka mohuar se në kompaninë ku

ai punon ka pasur ngritje të çmimeve. Lënda e parë për prodhim dhe përpunim, sipas tij, është duke u bërë nga vendet e rajonit dhe nuk është rritur kostoja e prodhimit. Ai thotë se kjo firmë ka 56 barkode në portofolin e vet me të gjitha llojet e çipsit. Ndërsa produktet e tyre, përveç tregut të brendshëm, eskortohen në Maqedoni në sasi të mëdha, Shqipëri, Bullgari, Hungari, Suedi, Danimarkë, Gjermani, në Zvicër, si dhe në Irak.





## Përkujtohet dëshmori Behxhet Shabani

SKENDERAJ, 5 MAJ (ER) - Me homazhe të varri i dëshmorit, nga drejtorët e Komunës së Skenderajt, familjarët, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Bekim Haxhiu, zëvendësministri Abdyl Ymeri dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, është përkujtuar heroi Behxhet Shabani nga Baksi, në 20-vjetorin e rënies së tij, në altarin e lirisë. Pas homazheve familjari i

dëshmorit para të pranishmëve ka evokuar kujtime për dëshmorin e kombit. Ndërsa deputeti Haxhiu ka thënë se Kosova dhe populli i saj do t'i kujtojë përgjithmonë dëshmorët për sakrificën e tyre sublime në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së vendit. Dëshmori Behxhet Shabani është përkujtuar edhe nga kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ka thënë se dësh-

morët ia kanë sjellë Kosovës lirinë. "Sot në 20-vjetorin e rënies në altarin e lirisë përkujtojmë me respekt dëshmorin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Behxhet Shabanin nga Baksi, i cili, bashkë me trimat dhe heronjtë tanë, i sollën Kosovës lirinë dhe pavarësinë. Lavdi gjakut të dëshmorëve të kombit!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

## Nga muaji qershor qytetarët e Fushë-Kosovës do të kenë furnizim me ujë 24 orë

MITROVICE, 5 MAJ (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina" sh.a., Ilir Abdullahu, ka vizituar punimet e vendosjes së gypit të ujit që po bëhen në Fushë Kosovë. Ai u njoftua nga afër me ecurinë e punimeve, duke i inkurajuar punëtorët për punën e palodhshme që po e bëjnë.

Abdullahu ka thënë se muaji maj do të jetë fund i një fillimi të ri sa i përket çështjes së zgjidhjes përfundimtare me ujë të pijshëm për qytetarët e Fushë-Kosovës. "Edhe ju konsumatorë të nderuar të këtij qyteti meritoni furnizim me ujë të pijshëm 24 h pa ndërprerë", ka thënë Abdullahu.



## FSK-ja ofron ndihmë për banorët e fshatit Pouskë pas sulmeve nga ariu i murrmë



Prizren, 5 maj (ER) - Duke iu përgjigjur shqetësimeve të fundit të banorëve të fshatit Pouskë të Komunës së Prizrenit në lidhje me dëmet e shkaktuara nga ariu i murrmë (kafshë e egër e mbrojtur me ligj), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka emëruar një komision për vlerësimin e masave që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e banorëve dhe pasurisë së tyre të shkaktuara nga ariu i murrmë. Në kuadër të këtyre vlerësimeve dhe masave MMPH/AMMK ka kontaktuar me shumicën e institucioneve relevante që mund të ofrojnë ndihmë dhe përkrahje për gjetjen e një zgjedhje të përshatshme për këtë rast. Meqenëse ky rast ndërlihet me

sigurinë e qytetarëve të cilët kanë ankesa të vazhdueshme se u rrezikohet jeta dhe kanë pësuar dëme të pasurisë së tyre, MMPH/AMMK ka kërkuar ndihmë dhe bashkëpunim edhe nga Forcat e Sigurisë së Kosovës. FSK-ja i është përgjigjur pozitivisht kësaj kërkesë dhe të dielën një ekip nga njësia ndërlihdhëse e FSK-së për reagim në rastet e krizave, së bashku me disa anëtarë të komisionit të formuar nga MMPH/AMMK, kanë dalë në vendin e ngjarjes. Ata kanë vizituar lokacionin dhe janë takuar me banorët e fshatit të cilët kanë pasur dëme nga ariu. Gjatë analizës së situatës dhe shqyrtimit të nevojave është konkluduar që zgjidhja më e mirë për ta tejkaluar situatën do të ishte ndërrimi i lokacionit për ariun e murrmë.

## Kurtan Kajtazi zgjedhet kryetar i PDK-së në Vushtrri

VUSHTRRI, 5 MAJ (ER) - Partia Demokratike e Kosovës ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor në Degën e Vushtrrisë, ku delegatët e pranishëm kanë zgjedhur kryetar të degës Kurtan Kajtazin, ndërsa ka zgjedhur edhe Këshillin Drejtues prej 71 anëtarëve si dhe 25 delegatë për Konventën Qendrore. Në emër të Komisionit

Zgjedhor të Degës, Lorik Maxhuni prezantoi sukseset e 58 kuvendeve të nëndegëve, ku kanë marrë pjesë mbi 4 000 anëtarë, të cilët zgjedhën drejtuesit e nëndegëve dhe delegatët e kuvendit zgjedhor të degës. Në emër të Kryesisë Qendrore dhe në emër të kryetarit Kadri Veseli delegatët e Kuvendit Zgjedhor në Vushtrri i për-

shëndeti ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Ai i ka falënderuar të gjithë mbështetësit e Partisë Demokratike të Kosovës për një angazhim të jashtëzakonshëm në procesin e brendshëm zgjedhor dhe për jetësimin e platformës Dekada e Re e cila, siç ka thënë Tahiri, do ta transformojë dhe zhvillojë Kosovën në rrugën drejt integritimeve euroatlantike.



# Personalitete të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe veprimtaria e tyre në Manastir

"Nëse doni ta zbuloni historinë para Krishtit dhe shkencat e asaj kohe duhet ta studioni gjuhën shqipe" / (Gottfried Wilhelm Leibniz, albanolog gjerman)



Prof. dr. Nusret PLLANA  
Universiteti "Hasan Prishtina"  
Fakulteti i Edukimit

## Përkufizimi

Tridhjetë vjet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Lëvizja Kombëtare Shqiptare organizon ngjarjen më të madhe, para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, organizon pra, Kongresin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe ose, siç njihet në literaturën historike, Kongresin e Manastirit.

Nismëtare e ngjarjes më të madhe të ekzistimit shpirtëror të popullit shqiptar, e organizimit të Kongresit të Manastirit, ishte Shoqëria Kulturore Kombëtare "Bashkimi", së cilës i printe Fehim Zavalani dhe vëllezërit Qiriazit.

Kush e përgatiti këtë ngjarje të madhe të kulturës sonë, të historisë sonë kombëtare?

Themelet i kishte vënë Rilindja Kombëtare, ajo që kishte krijuar edhe përmasën e kombit shqiptar. Ata ishin mendjet e ndritura të kombit, që kishin për ideal të veprimtarisë së tyre lirinë e atdheut, tërësinë e tij dhe zhvillimin e kulturës kombëtare. Por kultura kombëtare, gjuha kombëtare, nuk mund të zhvillohej pa një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

## Hyrje

Manastiri ishte qendër e njërit nga vilajetet shqiptare nën Perandorinë Osmane. Si i tillë, ishte edhe qendër e zhvillimeve të mëdha të lëvizjeve kombëtare. Kush nga rilindësit tanë nuk kishte vepruar, nuk kishte punuar dhe nuk kishte lënë gjurmë në historinë e zhvillimeve të veprimtarive kombëtare të cilat selinë e kishin në Manastir?

Edhe Lidhja shqiptare e Prizrenit, por edhe lëvizjet e mëvonshme,

njëren nga qendrat e zhvillimit të këtyre veprimtarive e kishin Manastirin. Deri edhe gjeneratat e mëvonshme të rilindësve tanë, siç ishte Lasgushi, që kishte bërë një pjesë të shkollimit këtu, apo edhe më i riu, Migjeni që, po ashtu, ishte arsimuar në Manastir, por edhe ushtarakë të Rilindjes sonë, të cilët do të bëhen prijës dhe organizatorë të krahut ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, janë pjesë e veprimtarive atdhetare dhe kulturore që kanë zhvilluar veprimtari të Rilindjes sonë Kombëtare në Manastir.

## Rilindja kombëtare dhe shkolla shqipe

Që në fillimet e saj, Rilindja Kombëtare Shqiptare një aspekt të zhvillimit të veprimtarisë së vet e kishte edhe përhapjen e arsimimit në gjuhën shqipe.

Pse mund të thuhet kështu?

Mund të thuhet për shumë arsye, por ajo që është kryesore ishte ndalimi i tërësishëm i mundësisë të shkollimit në gjuhën shqipe, pa marrë parasysh përkatësinë fetare të shqiptarëve. Do të thotë, nuk ishte pengesë përkatësia fetare, por pengesë e shkollimit në gjuhën amtare ishte përkatësia etnike e shqiptarëve.

Siç dihet tashti më, gjuha shqipe ishte e vetmja gjuhë në Evropë që ishte ndaluar me Ferman sultanor. Do të thotë, ishte e ndaluar të mësohej në të gjitha nivelet e shkollimit, qoftë edhe ato që kishin hapur autoritetet osmane, qoftë edhe ato që kishin hapur fqinjët tanë, që kishin qëllime zhdukjen e racës shqiptare. Prandaj, nuk është aspak e rastit se në të katër vilajetet shqiptare kishte aq shumë shkolla në gjuhën e ortodoksisë greke, në gjuhët sllave, në gjuhën osmane, si dhe në gjuhë të tjerëve, por nuk kishte shkolla në gjuhën shqipe.

Prandaj, nuk është aspak e rastit se në Evropën e shekullit nëntëmbëdhjetë vriteshin, helmoheshin dhe ndiqeshin nga vendi i tyre mësuesit shqiptarë, qoftë edhe kur mbanin mësimin e gjuhës shqipe fshehurazi, qoftë edhe kur hapej ndonjë shkollë me lejen e

sulltanit, por autoritet lokale osmane, të cytur edhe nga armiqët tanë shekullorë, grekët dhe sllavët, i shkishëronin, i ndiqnin jashtë vendit, i helmonin dhe i vrisnin mësuesit e shkollës shqipe. Është e vetmja shkollë në Evropë e cila në themelet e veta e ka gjakun e mësuesve tanë, dëshmorë të kujtesës sonë historike.

Rilindja jonë kombëtare, duke njohur rëndësinë e madhe të arsimimit të popullit shqiptar, përveç përpjekjeve për liri kombëtare, një krahë të zhvillimit të veprimtarive të saj atdhetare ia kishte kushtuar edhe hapjes së shkollave në gjuhën shqipe, qoftë kur ato punonin edhe fshehurazi, apo të maskuara nëpër mejtepe e altare kishash, në të cilat punonin atdhetarë shqiptarë.

Në këtë frymë kombëtare, me idealin e arsimimit të popullit ishin brumosur edhe të gjithë intelektualët shqiptarë jo vetëm që shkruanin librat për mësonjëtorët e para shqipe, siç ishin Konstantin Kristoforidhi e Naim Frashëri, Nikoll Naço e Sami Frashëri, Shahin Kolonja e Parashqevi dhe Sevasti Qiriazit, deri te Hasan Prishtina e Bajram Curri që, përveç pushkës, ia kishin kthyer pushtuesit të tokave shqiptare, edhe armën më të fuqishme të një populli, përhapjen e shkollës në gjuhën amtare.

## Brezi i rilindësve shqiptarë dhe ABC-ja e Kongresit të Manastirit

Nëse shqyrtohet me vëmendje, vetëm një aspekt i veprimtarëve të Rilindjes sonë Kombëtare, ai i letërkëmbimit, kur Shoqëria Kombëtare "Bashkimi" e Manastirit u kishte bërë thirrje qyteteve, klubeve, shoqatave kulturore brenda e jashtë vilajeteve shqiptare, për mbajtjen e Kongresit të Manastirit, mund të kuptohet drejt përkushtimi i të gjithë atyre intelektualëve të kohës, pjesë e Rilindjes sonë Kombëtare, si dhe gatishmëria e tyre, që të krijohej një alfabet i përbashkët i gjuhës shqipe, të cilin gjuha jonë e ka edhe sot.

Nuk di cila është vlera më madhore e këtij projekti të madh kombëtar, që e kishte filluar Rilindja Kombëtare dhe po e përfundonin përfaqësuesit e saj më të ditur, më atdhetarë dhe më të përkushtuar, duke vënë bazat e alfabetit të një gjuhe moderne, siç është gjuha shqipe.

Këta veprimtarë të Rilindjes sonë Kombëtare ishin nga të gjitha viset shqiptare por, mbi të gjitha, kishte nga ata që ishin edhe të penës dhe të pushkës, siç ishin

vëllezërit Bajo dhe Çerçiz Topulli, siç ishte Mihal Grameno, e shumë të tjerë, kishte nga ata që ishin bërë zëri i literaturës kombëtare, siç ishte Gjergj Fishta e Mit'hat Frashëri, djalë i prijësit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashërit, si dhe nip i poetit kombëtar, Naim Frashërit, e enciklopedistit Sami Frashëri. Nga këta rilindës, veprimtarë që tërë jetën ia kishin kushtuar lirisë dhe përparimit të kombit, të cilët pak vjet më vonë do të jenë hartuesit e Programit të Pavarësisë së Shqipërisë, siç ishte Luigj Gurakuqi dhe pjesëmarrës të tjerë të Kuvendit Historik të Vlorës së Ismail Qemalit.

Nëse shqyrtohen me paanësi puna dhe përpjekjet e këtyre rilindësve tanë, qoftë edhe vetëm në këmbënguljen e tyre për t'i dhënë shqipes alfabetin e saj modern, siç e kishin gjuhët e tjera të popujve modernë evropianë, atëherë mund të thuhet se angazhimi i tyre kishte vetëm një qëllim - interesin kombëtar, i cili ishte nëpërkëmbur nga të gjithë pushtuesit, andaj edhe nga Perandoria Osmane e kohës. Këta dijetarë, atdhetarë të papërkulur, kishin arritur, si rrallëherë në historinë tonë kombëtare, që t'i kapërcenin mosmarrëveshjet e tyre, të klubeve, apo shoqërive, të qyteteve apo të mërgatës shqiptare, duke dhënë shembullin më të mirë për historinë tonë, edhe të sotme, se vetëm bashkimi është në shërbim të zgjidhjes së çështjeve të mëdha kombëtare, siç ishte në vitin 1908, Kongresi i Manastirit, siç ishte vite më herët Lidhja Shqiptare e Prizrenit, siç ishte vite më vonë Kongresi i Elbasanit, e veprimtari të tjera që kanë rritur përmasën kombëtare të rilindësve tanë në shërbim të atdheut, të lirisë së tij, të tërësisë së tij dhe të arsimimit të tij.

Në letërkëmbimin që ruhet edhe sot, edhe pse i përgjysmuar dhe i shkatërruar nga pushtues të ndryshëm, shihet se rilindësit tanë, ata më të përkushtuarit, që një pjesë të veprimtarisë së tyre e kishin zhvilluar edhe në Manastir,

kanë sakrifikuar aq shumë nga bindjet e tyre, nga pikëpamjet e tyre, vetëm që të krijohet një vlerë me përmasë kombëtare, siç ishte alfabeti i gjuhës shqipe, pa të cilin askush nuk mund të thotë me saktësi se çka do të kishte ndodhur me rrugën e zhvillimit të gjuhës sonë kombëtare.

## Përfundim

Veprimtaria e rilindësve tanë, edhe ajo që është zhvilluar në Manastir, është bërë pjesë e kujtesës sonë historike, është bërë vlerë e trashëgimisë sonë kombëtare. Qoftë edhe vetëm për këtë fakt të madh historik, ata janë shembulli më i mirë i edukimit kombëtar për të gjithë brezat e shqiptarëve. Kush mund të ketë vetëdijen kombëtare të Gjergj Fishtës, për atë kohë, kryetar i Komisionit të Alfabetit, kur heq dorë nga varianti i alfabetit që kishte propozuar, vetëm që të arrihej sukcesi i Kongresit të Manastirit. Kush mund të marrë me mend sot, qoftë edhe vetëm udhëtimin e Parashqevi Qiriazit, nga Korça në Manastir, në atë kohë, më shumë se dy ditë e dy net rrugë, duke e bërë natën edhe nëpër bujtinat anës rrugëve, pa vënë gjumë në sy, sepse keqbërësit, qofshin edhe të porositur nga pushteti okupues, ishin të pranishëm kudo, e cila kur sheh punën e madhe të rilindësve tanë në atë Kongres, shkruan poezinë, himnin e alfabetit, që edhe sot do të ishte aktual. Një popull që i harron këto ideale të veprimtarëve të Rilindjes sonë Kombëtare nuk ka kujtesë historike dhe nuk ka edukim kombëtar.

Manastir, më 27 prill 2019

## Burimet:

Shaban Demiraj-Kristaq Prifti, "Kongresi i Manastirit", Tiranë, 2004

Grup autorësh, "Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit", Tiranë, 1972

Tomorr Osmani, "Udhë e shkronjave shqipe: histori e alfabetit", Tiranë, 2008



## Luftë me raketa mes Hamasit dhe Izraelit, ka viktimat e të plagosur

TEL-AVIV, 5 MAJ - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, tha të dielën se ka urdhëruar ushtrinë për sulme të mëdha kundër militantëve në Gaza, derisa po vazhdon rritja e armiqësisë për ditën e tretë në kufirin që ndanë dy vendet. Një sulm ajror nga Gaza la të vrarë një civil izraelit të dielën, derisa dy palestinezë të armato-

sur u vranë nga sulmet ajrore të Izraelit.

Ushtria e Izraelit tha se të paktën 450 raketa kanë pasur për cak qytetet jugore të Izraelit dhe kanë sulmuar 220 caqe të grupit militant të Gazës.

Raundi i ri i dhunës filloi dy ditë më parë kur një snajper i xhihadi islamik, qëlloi trupat izraelite duke lënë të plagosur dy ushtarë.

Shpërthimi i luftimeve vjen pasi liderët e Hamasit, grup militant që kontrollon Gazën, dhe një grup i vogël islamik ishin në bisedime në Egjipt për të arritur armëpushim.

Tensionet janë rritur ditëve të fundit pas dyshimeve nga Hamasi se Izraeli po e vonon implementimin e armëpushimit të dakorduar.



## Brexit dhe shanset për një marrëveshje mes konservatorëve dhe laburistëve



Gjatë javëve të fundit palët janë ngërthyer në bisedime në një përpjekje për të ndërmjetësuar një marrëveshje për Brexitin që do të mund të miratohej në parlament, pas tri dështimesh të forta të planit të kryeministres May për ndarje nga BE-ja

LONDËR, 5 MAJ - Kryeministrja britanike Theresa May duket e hapur të bëjë lëshime për një marrëveshje që do ta siguronte shumicën në parlament pas tri dështimesh të

planit të saj për Brexit. Kryeministrja May ka shtuar thirrjet ndaj kreut të Partisë Laburiste Jeremy Corbyn për të rënë dakord për një marrëveshje

ndërpartiake për shkëputjen e vendit nga Bashkimi Evropian. Thirrjet vijnë në një kohë kur të dyja partitë shënuan rezultate të dobëta në zgjedhjet lokale të 2 majit.

Gjatë javëve të fundit palët janë ngërthyer në bisedime në një përpjekje për të ndërmjetësuar një marrëveshje për Brexitin që do të mund të miratohej në parlament, pas tri dështimesh të forta të planit të kryeministres May për ndarje nga BE-ja. Sipas gazetës "Sunday

Times", konservatorët pritet t'u bëjnë lëshime të reja laburistëve me rifillimin e bisedimeve të martën (7 maj), përfshirë një mundësi për bashkim doganor të përkohshëm me Bashkimin Evropian, që do të zgjaste deri në zgjedhjet kombëtare të qershorit 2022.

Për ta mbështetur planin e Mayt për t'u larguar nga BE-ja, udhëheqësi i partisë Laburiste, Jeremy Corbyn, ka vendosur si kusht

bashkimin e përhershëm doganor me BE-në, por konservatorët e kundërshtojnë një gjë të tillë. Sipas tyre, kjo gjë do ta pengonte Britaninë që t'i arrinte marrëveshjet e saj tregtare me vendet e tjera. Ndërkohë shefi për politikën financiare të partisë Laburiste, John McDonnell, në një intervistë të dielën për BBC-në akuzoi kryeministren Theresa May se ka thyer kushtet e bisedimeve konfidenciale me partinë laburiste të opozitës mbi një kompromis lidhur me Brexitin duke shtuar se asaj nuk mund t'i besohet më. "Jo! Më vjen keq, por jo nuk mund t'i besohet më, pas kësaj fundjave kur ajo ka hedhur në erë konfidencialitetin dhe mendoj seriozisht se ka rrezikuar negociatat për interesat e saj personale", tha ai.

Por, megjithatë, McDonnell tha se bisedimet do të vazhdojnë më vonë gjatë kësaj jave dhe nëse mund të arrihet një marrëveshje, kjo duhet të ndodhë sa më shpejt. Kreu i partisë Brexit, Nigel Farage, tha të dielën se një marrëveshje mes konservatorëve dhe laburistëve për shkëputjen nga BE-ja, që do të përfshinte një bashkim doganor, do të shihej si një koalicion politikanësh kundër popullit dhe si tradhti.

Nuk është e qartë nëse Bashkimi Evropian do të miratonte një marrëveshje doganore të përkohshme, në kushtet kur në një periudhë kohore më të vonë do të nevojiteshin kontrollet kufitare në mes të Irlandës dhe Irlandës së Veriut, në rast të prishjes së marrëveshjes.

## Irani do të vazhdojë pasurimin e uraniumit pavarësisht presionit të ShBA-së

TEHERAN, 5 MAJ - Kryeparlamentari i Iranit, Ali Larijani tha se vendi do të vazhdojë pasurimin e uraniumit në pajtim me marrëveshjen bërthamore me disa fuqi botërore, pavarësisht presionit të Shteteve të Bashkuara për të ndaluar këtë veprim. "Nën marrëveshje bërthamore, Irani mund të prodhojë sasi të madhe të ujit dhe kjo nuk është në kundërshtim me marrëveshjen. Prandaj, ne do të vazhdojmë me aktivitetin e pasurimit", tha Larijani. Shtetet e Bashkuara, në krye me presidentin Donald Trump, kanë

shtuar presionin ndaj Qeverisë së Iranit për të ndaluar, siç i quajnë, "aktivitetet malinje në rajon".

Më 3 maj administrata e Trumpit ka vendosur ndalesa të reja në aktivitetet bërthamore të Iranit, për të detyruar Teheranin të ndalojë prodhimin e uraniumit të varfëruar dhe zgjerimit të termocentralit të vetëm bërthamor. Pavarësisht rritjes së presionit ndaj Iranit, Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar se kanë vazhduar me heqjen e pesë sanksioneve që do t'i mundësojë Rusisë, Kinës dhe shteteve evropiane të vazhdojnë të punojnë me programin



civil bërthamor të Iranit. Presidenti iranian Hassan

Rouhani, tha të shtunën në një transmetim direkt në televizionin

shtetëror, se Irani duhet t'i luftojë sanksionet e ShBA-së duke vazhduar të eksportojë naftë si dhe të rris eksportin e produkteve të tjera. "Amerika po tenton t'i ulë rezervat tona të jashtme por ne duhet t'i rrisim të ardhurat nga monedha dhe të shkurtojmë shpenzimet në valutë", tha Rohani.

ShBA-ja e ka goditur Iranin me sanksione të rënda ekonomike, pas vendimit të presidentit amerikan, Donald Trump, në maj të vitit 2018, për t'u tërhequr nga një marrëveshje bërthamore me Iranin dhe fuqi të tjera botërore.



# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



Recension

# Një shqiptim artistik në shumë pamje i luftës së UÇK-së



Prof. ass. dr. Ragip  
GJOSHI

Që në kohën e Rilindjes sonë Kombëtare thënia e njohur "Me pushkë e penë për lirinë e atdheut" ka qenë motiv për shumë lëvizje për çlirim dhe vendit. Me penë dhe pushkë çështja shqiptare u trajtua edhe në tryezat e kancelarive të Evropës. Edhe krijimtaria e shkrimtarëve në atë epokë që shndërruar në program kombëtar. Dhe, derisa koha po ecte përpara, jashtë truallit shtet londinez, me pak më shumë se 28 mijë metra katrorë, krajlitë i lanë shqiptarët të shpërndarë në pesë shtete, me pesë qeveri, pushtete, kufij, pasaporta dhe ideologji të ndryshme. Por, më në fund (1999) erdh koha të dridhet fort diplomacia ndërkombëtare dhe aleanca e NATO-s, duke i dalë në mbrojtje Kosovës, komandant Adem Jasharit, e duke shkuar pas tij një ushtri e tërë - UÇK-ja. Në vitet 1998-1999 dikush ngjeshi armët e lirisë, dikush shtroi sofrën e bukën për trimat, e dikush mprehu penën e publicistikës dhe shkri vepra letrare (prozë, dramë, poezi, operë etj). Kësaj plejade shkrimtarësh i takon edhe krijuesi letrar i pasionuar Metë Nimani, që para lexuesve vjen me dramën prej 436 faqesh, me titull "Mallkimi i epsheve të gjakut". Kjo dramë sjell motive nga periudha e qëndresës, e sakrificës, e trimërisë, e heroizmit dhe e lavdisë. Baca Metë dokumenton në vepër rrethanat politike të vështira të diktaturës që ka përjetuar ky autor (tash veteran i arsimit dhe veteran i UÇK-së) si dhe shumë intelektualë bashkëmoshatarë të autorit në Kosovë, nga "rojet e mjegullës", nga UDB-a. Në veprimtarinë e vet letrare autori vokacion e ka historinë dhe të kaluarën tonë. Nimani deri më tani ka botuar romanin historik "Ai e vrau vdekjen time", me tematikë nga lufta e UÇK-së, pastaj tragjedinë nga lufta e Kosovës "Dy lule në bankën e tretë". Ndërkaq, ka në dorëshkrim edhe një vistër veprash letrare, ditar lufte, si dhe dorëshkrimin e pjesës së tretë të dramës me të njëjtin titull.

## Dramë me motive nga lufta e UÇK-së

Drama "Mallkimi i epsheve të gjakut" sjell motive nga lufta e UÇK-së, motive të heroizmit e të trimërisë së luftëtarëve gjer në sakrificën e flijimit e tyre për liri. Në të dyja pjesët e në tetë pamjet e kësaj drame janë dhënë ngjarje reale brenda një familjeje, një treve, sidomos në regjionin që ishte nën kontrollin e Brigadës 132 të ZOD, ku tërë jeta e tyre bëhet sinonim i luftës. Duke përshkruar aktivitetet e luftëtarëve të UÇK-së në një anë dhe dëmet që sillnin disa nga bashkëpunëtorët shqipfolës në anën tjetër, që përbëjnë boshhtin kryesor të dramës, autori të gjitha ngjarjet i këndvështron në mënyrë konvencionale, duke rrëfyer karakterin e luftës, qenësinë e luftëtarëve brenda të cilëve mbretëron një atmosferë e denjë njerëzore dhe atdhetare. Kështu, dramaciteti i ngjarjeve bëhet ekuivalent me zhvillimet në të gjitha subjektet e kohës së luftës. Në dramë ngjarjet kundrohen nga shumë pamje e skena që t'i përkujtojnë tatëpjetat apo ngritjet, kudo me frymën heroike, frymën kombëtare dhe sfidën e familjeve shqiptare të anës së Dushkajës së Gjakovës për sakrificë deri në çlirim. Pra, çështje themelore në këtë dramë është gatishmëria e djemve të lirisë në përballje me armikun pa marrë parasysh çmimin. Në mesin e galerisë së personazheve do të shqueshin ata negativë: Dula, që këtu është prototip i bashkëpunëtorit të armikut, Bani na del si një prej vetave të kësaj drame që paraqet fytyrën e një shqiptari që përka Dulen, por që, sadopak, ruan një konsideratë morale për luftëtarët, Komandiri i milicisë, milicët. Përballë tyre janë personazhet pozitivë, si: Plaku, Bardhja, Doktor, Gimi, Nëna Piku, Arta, fshatarët të cilët ishin në rrugën e nderit. Edhe pse emrat janë të trilluar, pothuaj çdo personazh i veprës duket real, që ka vepruar në Kosovë. Disa prej tyre ishin me vlera të larta morale të traditës shqiptare, që pasqyrohen përmes dialogëve të luftëtarëve me popullatën civile. Në dramë dominojnë portretet e luftëtarëve në fushëbetëjat e UÇK-së.

Drama fund e krye është e përshkruar me atmosferën e ditëve të lavdisë dhe të heroizmit të rrallë e të pakrahueshëm ndër epokat e historisë sonë. Ky libër, me UÇK-në në ballë të

udhës së lirisë, është një dramë origjinale, sepse ngjarjet që përjetohen në të janë ngjarje pa ndonjë ngarkesë dhe s'kanë të bëjnë me paradokse si në disa drama të tjera. Tërë dramën e përshkon një skenë e hapur, ku autori vë përballë personazhet pa konflikt me njëri-tjetrin, edhe pse janë të kategorive të ndryshme. Lufta në linjën nga vdekja - e emërtuar "pavdekësi" - merr konotacion sa tronditës, po aq edhe krenar. Armiku ua djeg shtëpitë, por popullata nuk i lëshon vatrat. Pra, akti i qëndresës së tyre në këtë dramë jepet si një trup unik, me personazhe që s'mendojnë për ndonjë alternativë tjetër, përveç të drejtës madhore - fitores dhe lirisë së Kosovës. Drama e Nimanit shquhet për një gjuhë dhe stil të rrjedhshëm, për ruajtjen e të folmes dhe nëndialektit gegërisht të trevës prej nga vjen autori dhe, mbi të gjitha, imazhin e luftëtarit dhe të njeriut të thjeshtë, që veprojnë bashkërisht për të luftuar dhe ndryshuar jetën. Gjithashtu, gjatë leximit do ta hetojmë thurjen e komikës apo elementeve komike së bashku, si dhe mënyrën e rrefimit nëpërmjet metaforës, krahasimit, alegorisë.

## Struktura dramatike dhe përbërësit e saj kompozicionalë

Në librin "Mallkimi i epsheve të gjakut" të autorit Metë Nimanit janë zbratur shfryrjet letrare dhe një mallkim artistik, të cilin autori është i bindur se një ditë do t'i zë të mallkuarit. Kjo vepër e re sjell një pasuri të thuktë leksikore, figurshmëri të bollshme dhe të kompletuar. Sa i përket strukturës dramatike dhe përbërësve të saj kompozicionalë, fabula dhe subjekti, thurja e intrigave, ndërtimi i karaktereve, duket se mbështetet në të dhënat e autorit që i mbante me kujdes, por edhe të ngjarjeve të luftës të para me sy vetë dhe nga të urtit, si dhe të vërtetat e UÇK-së në Kosovë, por të thëna artistikisht.

Të gjitha ngjarjet e kësaj drame janë të përjetuara nga njerëzit. Sepse janë shumë reale. Por, të gjitha zhvillimet e ngjarjeve të luftës së Kosovës, të ndodhura në një pjesë të Dushkajës së Dukagjinit në vitet 1998/'99, autori i ka thënë artistikisht në këtë vepër. Në brendinë e kësaj veprë shikohen gjëra të pakëndshme të komunitetit mes ndasive, të cilat e zbehnin

paksa vullnetin serioz të brezave të rinj të cilët edhe ishin përcaktuar për të gjitha sfidat. Në brendinë e tekstit dalin në pah zënkat e kundërshtimet, por edhe shkurt-pamësitë e tipave si Dula me pak shokë, si personazhe negative që i ruanin me xhelozzi idealet e komunizmit, por edhe të regjimit okupes që ishte kapur qëmoti me kumbarët, si meshkuj shtëpie dhe pa havale fare.

Personazhi i emërtuar Vajzë, emër ky i përbërë nga kompozita Vaj+zë, që ishte pagëzuar nga gjyshi i saj, atë e zëvendësoi me emrin Fitore, sepse familja e saj tërë jetën e kishte kaluar vetëm me vaje dhe tmerre. Kështu kishte ndodhur jo vetëm me këtë familje, por edhe me shumicën e familjeve të lirisë dhe të libërësve në mbarë vendin. Pagëzimi kishte ardhur si një ide për të dokumentuar se një popull i tërë është rritur dhe ka mbijetuar në vaje dhe se vaji është këngë e burrit.

Autori përmes gojës së Gjyshit rikujton kujtesën historike se "duhej ta pyesnim regjimin edhe për emrat e fëmijëve". Kështu që Vajza, kur e kupton etimologjinë e emrit të vet, e ndërron atë, duke e pagëzuar vetveten Fitore. Kurse personazhi, Bardhi, i plagosur, duke hequr plumbin nga trupi dhe duke e nxjerrë në dritë, lexon letrën e të panjohurit, i cili

kishte rënë në amshim me fjalët "që mos ta harronim amanetin për bashkimin e kombit tonë sepse ashtu edhe jemi përcaktuar dhe betuar kur dhamë edhe kushtimin!"

Autori Metë Nimani i kishte zgjedhur si personazhe kryesore Vajzën, Bardhin, por edhe komandant "Tigrin!" Autori komandant "Tigrin" e personifikon me një legjendë që fliste edhe me shkëmbinj e lisa. Ai fliste edhe me Sukën e Shenjtë, por vetëm Gimi me Bardhin mund ta dëgjonin, askush tjetër. Nimani duket se kishte arsye të fuqishme që fliste për mitet e Sukës, e cila ishte mbrojtur nga engjëjt tanë. Prandaj Gimi dhe Bardhi nuk e ndienin fuqinë e "Tigrin" si diçka mistike sepse vërtet Suka e Shenjtë ishte mbrojtje për katër ditë e net me radhë nga bijtë e saj, uniformat me ngjyrë mali, nga ushtarët me emblemën e UÇK-së.

Për herë të parë, sipas autorit, këto troje përballen dy ushtri në këtë pjesë të Ballkanit: UÇK-në dhe AJ-në. Autori përshkruan dinjitetshëm luftën çlirimtare dhe qëndresën e UÇK-së. Zëri i kushtimit të komandant "Tigrin" përdridhet në brendi të dramës së Nimanit "Kemi nis një dasmë të madhe!" As aeroplanët MIG që përdori ushtria serbe mbi popullatën shqiptare nuk bënë punë që të pushtohet Suka e Shenjtë.



# 'Bardhësitë e atdheut', informacion i domosdoshëm për krejt atdheun tonë

**Mr. Sc. Ph. D(c). Kemail  
SHAQIRI**

Afrim Mustafa ishte dhe mbetet i përkushtuar që të vërtetën e luftërave të UÇK-së ta çojë deri në fund. Ai qysh në ditët e hershme u kyç në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si gazetar, por edhe me pushkë në dorë. Si zakonisht, vendi i parë ku ai u shfaq ishte Prekazi heroik i Adem Jasharit dhe Drenica heroike, për ta vazhduar pastaj gjithandej Kosovës, kudo që kishte nevojë për ta zbardhur të vërtetën mbi luftën e UÇK-së. Njëherë shumë vende, Afrimi ishte nëpër vijat e frontit, duke raportuar për luftimet e njësiteve të UÇK-së. Por, ai, kur e kërkonte nevoja, ishte edhe në vijën e parë të frontit si ushtar, në të njëjtën kohë edhe reporter i ngjarjeve luftarake. Sot z. Mustafa na ka dhuruar një vepër të çmuar dhe të lavdishme, "Bardhësitë e atdheut", e cila është pasuri shumë e veçantë për çdo shqiptar në trojet shqiptare.

Shumë herë flitet që informacioni është "Arma" më e fortë që disponon një institucion, apo strukturë e krijuar dhe e cila doemos duhet të funksionojë

sipas nevojave dhe kërkesave të kohës dhe, karshi situatave të cilat shfaqen në përditshmërinë e jetës sonë shoqërore, qofshin ato si të rregullta apo edhe fenomene të cilave duhet t'u përgjigjemi. Prandaj, informacioni është aq i rëndësishëm sa edhe vetë ekzistenca e njeriut për të krijuar diçka të nevojshme dhe në hap me kohën, e cila nganjëherë edhe na imponon situatat e vështira dhe me plot sfida. Nga sfidat më të cilat populli shqiptar është ballafaquar historikisht, është vështirë për të dalluar se cilat kanë qenë më të vështira, duke mos u dalluar shumë njëra nga tjetra. Një nga këto sfida të kohës moderne të fundshekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI ishin luftërat e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe asaj e UÇPMB-së, pra në Maqedoninë Veriore dhe Kosovën Lindore dhe përcjellja e tyre në mënyrë permanente. Me këtë sfidë të veçantë u përball edhe intelektual i përmasave të rralla, i cili raportimet dhe veprimtarinë luftarake dhe atdhetare e kurorëzoi edhe me nxjerrjen në dritë të një kapitali shumë të veçantë e të rëndësishëm. Për t'u përballur me këtë sfidë është dashur që të kesh: vullnet, guxim dhe të jesh

atdhetar. Por, dikush ka këto tipare dhe i përvishet punës pa u frikësuar nga rreziqet. Një nga personalitetet e gazetarisë dhe të informacionit është gazetari dhe reporteri i luftërave, Afrim Mustafa. Një veprimtar i sakrificës, përkushtimit, i cili, përveç fjalës së lirë, objektive, me rëndësi të cilën e transmetoi gjithandej shqiptarisë dhe më gjerë, nga ai jehoi edhe gryka e pushkës, duke mos u ndalur deri në lirinë e trojeve tona. Kështu, u arrit sensibilizimi i çështjes së Kosovës edhe në botën demokratike, që shqiptarët e duan lirinë, e duan fjalën e lirë dhe që mos të jenë të huaj në shtëpinë e tyre, duke vuajtur nën robërimin e pushtuesve nëpër të gjitha fazat e historisë.

Afrimi ishte dhe mbetet i përkushtuar që të vërtetën ta çojë deri në fund. Ai qysh në ditët e hershme u kyç në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si gazetar por, edhe me pushkë në dorë. Si zakonisht, vendi i parë ku ai u shfaq ishte Prekazi heroik i Adem Jasharit dhe Drenica heroike, për ta vazhduar pastaj gjithandej Kosovës, kudo që kishte nevojë për ta zbardhur të vërtetën mbi luftën e UÇK-së. Afrim Mustafa ishte nëpër disa vija të frontit, duke raportuar për

veprimet luftarake të njësiteve të UÇK-së. Por, ai, kur nevoja e kërkonte, ishte edhe në vijën e parë të frontit, tashmë i si ushtar i lirisë, në të njëjtën kohë edhe reporter i ngjarjeve luftarake.

**"Bardhësitë e atdheut"  
duhet ta ketë çdo familje  
shqiptare**

Gazetaria dhe puna e reporterit luftarak është punë që kërkon përkushtim dhe guxim prej gazetarit prandaj nuk ishte punë e lehtë që Afrimi e kryente, karshi luftës dhe betejave që zhvilloheshin me forcat e armikut sepse ai kishte obligim edhe ta njoftonte opinionin dhe popullatën për ngjarjet dhe ndodhitë në vijat e frontit. Këtë detyrë shtesë Afrimi si çdoherë e kryen me përpikëri dhe nuk ndiente as lodhje e as frikë, edhe pse ishte në moshë të re, por ia arriti që me shumë sukses t'i përmbyle të gjitha detyrat e një reporteri, që nuk ishte aspak e lehtë.

Afrimi përcolli të gjitha luftërat që ndodhën në Kosovë, Maqedoni dhe në Kosovën Lindore. Për këtë ai hartoi, punoi dhe botoi me shumë sukses librin "Bardhësitë e atdheut", me 1 841 faqe e me gjithsej 17 200 fotografi nga vijat e frontit dhe të

popullatës në arenën e të tri luftërave. Prandaj, me arsye të plotë ky libër quhet enciklopedi që deri sot asnjëherë përpara nuk e ka parë tregun e shkrimit, por edhe shkencës mbi shpjegimin dhe përshkrimin e luftërave me foto, fjalë dhe fakte. Shumë personalitete shtetërore dhe institucione të tjera janë të njoftuar për këtë enciklopedi, e cila është e pëlqyer nga të gjithë, pasi është bërë një punë kolosale përplot 20- vjeçare për ta parë dritën e bardhë. Ky libër, pra kjo enciklopedi e veçantë, për çdo lexues dhe adhurues të librit ia vlen të vendoset në bibliotekat personale, në shtëpitë tona dhe në institucionet tona. Jam i sigurt se shumëkujt kjo vepër madhore do t'i shërbejë edhe për temë magjistrature e doktoraturë dhe për arritjet shkencore t'i bëjmë drejtpërdrejt përmes kësaj enciklopedie me emrin dhe me përmbajtjen më të veçantë, "Bardhësitë e atdheut". Unë si ushtarak i karrierës dhe njohës prej eksperti i luftërave dhe doktrinës ushtarake do t'ia rekomandoja çdo personi, por edhe institucioni.

**Dortmund, 25 prill 2019**

*(Autori ka qenë ish-epror i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës)*



E jashtëzakonshme

## Njihuni me burrin me më shumë gishta në botë

Devendra Suthar mban rekordin si burri me më shumë gishta në botë. Ai ka plot 28 gishta. 46-vjeçari është bërë pjesë e Librit të Rekordëve "Guinness" pasi ka katër gishta më shumë në këmbë dhe katër gishta më shumë në duar. Në secilën prej katër gjymtyrëve ai ka shtatë gishta.



FOTO E DITES




Një burrë bën selfie me një qen në Shanghai të Kinës. /AFP/

E rrallë

## 32-vjeçari mbijeton pasi bie në vullkan

Një ushtar amerikan në Hawaii është në gjendje kritike pasi ra në një prej vullkaneve më aktive në tokë. Policia ka shpëtuar 32-vjeçarën, i cili thuhet se u ngjit me një litër metalik për ta parë vullkanin Kilauea në Hawaii. Dëshmitarët thonë se toka u nda në disa pjesë duke shkaktuar që ai të binte në shkëmbin 91 metra. Falë kësaj, ushtari u mbajt në buzë të shkëmbit për të mos rënë në kraterin e zjarrtë.




**DASHI**  
E keni marrë të mirëqenë të gjithë

përkujdesjen dhe dashurinë që të tjerët kanë shprehur karshi jush sa tani jeni bërë dhe prepotent.



**DEMI**  
Keni qartësuar më në fund një situatë

që iu përket më shumë ndjenjave tuaja sesa punës. Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm për çka keni vendosur.



**BINJAKËT**  
Mbase i keni mbivlerësuar

kolegët me të cilët punoni, sepse sot do të vëreni që keni lënë shumë gjëra të paqarta në një projekt pune.



**GAFORRJA**  
Nuk mund të ndryshoni në çdo çast

programet tuaja për shkak të të tjerëve. Do të ketë mbivendosje takimesh sot për ju.



**LUANI**  
Keni shkuar shumë larg me

fantazinë sot dhe do t'ju duhet të ktheheni me këmbë në tokë. Një çështje e vogël familjare do t'ju përmendë.



**VIRGJËRËSHA**  
Nëse nuk jeni të sigurt për hapat që

keni hedhur mbase duhet të rimendoni një plan tjetër për të qenë më konkrete aty ku duhet.



**PESHORJA**  
Po mundoheni të hapni sa më shumë

horizontet tuaja, por do të hasni në kundërshti me persona që juve duan t'ju shohin sa më të mbyllur.



**AKREPI**  
Nëse nuk e keni gjetur ende rrugën e

duhur dhe ndiheni të porealizuar atëherë duhet të provoni përsëri. Nuk ka rëndësi se kur e filloni eksplorimin.



**SHIGJETARI**  
Edhe pse persona të caktuar nuk janë në

kontakt të drejtpërdrejtë me ju mund të influencojnë te të tjerët për të krijuar probleme.



**BRICJAPI**  
Mund ta përhapni përkujdesjen dhe

dashurinë tuaj tek të gjithë sot, si njerëzit e dashur edhe kolegët që ju rrethojnë. Do të ndiheni të plotësuar.



**UJORI**  
Siç ju ndodh rëndom, keni

humbur objektivat parësore dhe jeni marrë me gjëra të vogla që kanë kondicionuar ditën tuaj.



**PESHQIT**  
Nuk do të thotë që kërkesat tuaja janë

urdhra dhe duhet patjetër të zbatohen. Nëse nuk e qartësoni këtë gjë me veten, do të gaboheni.

BARSOLETA E DITËS



Në një maternitet dy të porsalindur po bisedonin:  
- Je djalë apo vajzë?  
- Djalë.  
- Ma vërteto.  
- Sapo të shkoj infermierja do ta tregoj.  
Sapo iku infermierja, vogëlushi tërhoqi kuvertën dhe i tha:  
- E shikon, kam çorape të kaltra.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.  
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

### "THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.  
Regjia: Joe Cornish




Në ora 22:00

### "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon  
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



## Sienna Milleri kapet me ish të dashurin



**S**ienna Milleri është parë me ish të dashurin e saj Tom Sturridge të premten që lamë pas në Nju Jork. Aktorja 37-vjeçare kishte të veshur një xhakëtë të gjatë të kom-

binuar me një kapele të verdhë, ndërkaq aktori dukej më sportiv. Së shpejti keni mundësinë ta shihni aktoren në seritë e "The Loudest Voice".

## Selma Blair po ndihet shumë e sëmurë



**S**elma Blair, aktorka që zbuloi diagnozën e saj, sklerozë të shumëfishtë në muajin tetor, përmes "Instagram"-it ka treguar se po trajtohet për sëmundjen e paparashikueshme, që shpesh e bën

atë të paafte në rrjedhjen e informacioneve të trurit. "Ja një e vërtetë. Ndihem shumë e sëmurë. Kam të vjella. Djali im iku, duhet ta çojë në shkollë. Trajtimet mjekësore po e bëjnë të veten", ka shkruar Blairi.



## Bebe Rexha ndryshon ngjyrën e flokëve

**K**ëngëtarja e famshme me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha, së fundi ka publikuar disa video në rrjetet sociale, ku u tregon adhuruesve

se ka ndryshuar ngjyrën e flokëve. Rexha ka ngjyrosur flokët ngjyrë rozë të çelët. Rexha së fundi ka publikuar këngën më të re "Last Hurrah".

## Chris Brown i përgjigjet Justin Bieberit



**C**hris Brown i është përgjigjur mikut të tij Justin Bieber, pasi ky i fundit në rrjetet sociale e ka krahasuar Chrisin me ekuivalentin e gjallë të Michael Jacksonit dhe Tupac Shakurit. Ai inkurajoi fansat e tij për ta dëgjuar muzikën e Chrisit dhe e vlerësonte atë. Chrisi u

përgjigj më pas në një postim. "Unë të dua njeri. Faleminderit që besove tek unë! Ti shkëlqen dhe zemra jote është e pakrahasueshme. Ti je një mbret, por më e rëndësishmja është se ju vërtet frymëzoni të tjerët dhe krijoni mundësi të pafundme", ka shkruar Chris.

# Shtëpia e Ismail Kadaresë në Tiranë kthehet në muze, ja si do funksionojë

Apartamenti ku punoi dhe jetoi njeriu i madh i letrave shqipe, Ismail Kadare shumë shpejt do të hapet si muze për t'u vizituar nga qytetarët e Tiranës dhe turistët që vizitojnë kryeqytetin. Pas vendimit të Këshillit Bashkiak, Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me arkitekten e njohur Elisabetta Terragni ka restauruar të gjithë apartamentin për kthimin në muze të shtëpisë së shkrimtarit të madh në Rugën e Dibrës.

Me vendimin e sotëm në Këshillin Bashkiak I hapet rruga kthimit të vendit ku Kadare shkroi disa nga kryeveprat e tij, në muze.

"I shërben përveç tërheqjes së sa më shumë turistëve dhe zgjatjes së qëndrimit të tyre. Ismaili është produkti më i njohur 'Made in Albania'. Krijohet një stacion tjetër në Tiranë jo vetëm Sheshi, liqeni, pazari I ri, kalaja, galeria, tani shtohet edhe

Shtëpia Kadare dhe më vjen shumë mirë që disa ditë më pas do kemi mundësi që dhe ta hapim", tha Veliaj.

Muzeu do të prezantojë për publikun vendës e të huaj një pjesë të historisë dhe kulturës materiale dhe shpirtërore të periudhës totalitare përmes pasqyrit të mënyrës së jetesës së shkrimtarit. Brenda apartamentit ekspozimi ndahet në mënyrë të qartë midis studios me dokumente origjinale, objekte, libra dhe mobilie dhe pjesës tjetër të banesës, ku merren njohuri për veprën e shkrimtarit dhe përfshihet këndi i leximit dhe ai SAL (souvenire, art dhe libra).

Me hapjen e një destinacioni me interes letrar e kulturor në krah të sheshit "Skënderbej", bashkia synon të tërheqë tregun ndërkombëtar turistik, krijon një vlerë të shtuar për kryeqytetin, rrit numrin e turistëve si dhe



edukon të rinjtë me veprat letrare të autorit me famë ndërkombëtare. Pjesë e projektit të bashk-

isë është edhe shtëpia e Dritëro Agollit, që gjendet një kat më lart në ndërtesën e famshme të para-

viteve '90, të njohur edhe si "pallati me kube" dhe që mbart një histori më vete.

## 500 vjetori i vdekjes së Leonardo Da Vinçit – disa fakte të rëndësishme të jetës së tij



### 1. Një fëmijë i paligjshëm!

Ai lindi si biri jashtë martesë i Piero Fruosino di Antonio Vinçit (babait) dhe Caterina (nëna). Prindërit e tij kurrë nuk u martuan dhe ai ishte i vetmi fëmijë i tyre. Megjithatë, ai kishte 17 gjysmë-vëllezër e motra me partnerë të tjerë të prindërve të tij.

### 2. Emri i një qyteti!

Ai lindi në Anchiano, Toscana (tani në Itali), që është afër qytetit të Vinçit, me të cilin ne e asociojmë mbiemrin e tij sot.

### 3. Pak ka arsimim formall

Përtej leximit dhe shkrimit bazë, ai nuk mori asnjë arsimim formall në ndonjë shkollë.

### 4. Personi që qëndron prapa aftësive të tij!

Talenti i tij artistik u vlerësua së pari nga babai i tij dhe kur Leonardo ishte 15 vjeç, babai e dërgoi të mësojë pranë piktorit dhe skulptorit Andrea del Verrocchio, në Firence. Ai përpunoi teknikat e skulpturës dhe pikturës së Leonardos për më shumë se një dekadë dhe e trajnoi atë në artet mekanike.

### 5. Piktura e tij më e hershme!

Megjithëse puna e tij e parë mendohet të jetë ajo e një vizatimi në stilolaps dhe bojë, e luginës së Amos (siç raportohet nga burime të ndryshme) më 5 gusht 1473, "Shpallja" (diku rreth 1472-1475)

mendohet të jetë vepra e tij më e hershme. Ajo paraqet engjëllin Gabriel, të cilit Perëndia i dërgoi fjalë, për të njoftuar virgjëreshën, Marinë, që ajo të krijonte dhe të lindte një djalë të quajtur Jezus, i cili do të quhej "Biri i Perëndisë".

### 6. Kur mësuesi u impresionua me punën e tij!

Ai ndihmoi mentorin e tij Andrea del Verrocchio në pikturën e famshme "Pagëzimi i Krishtit". Piktura përshkruan pagëzimin e Jezusit nga Gjon Pagëzori. Është thënë se engjëlli në të majtë u pikturua nga Leonardo i ri dhe kjo ishte një gjë, e cila i bëri shumë përshtypje mësuesit të tij.

### 7. Shkrimi, nga e djathta në të majtë!

Leonardo da Vinçi ishte majtosh dhe ishte mësuar që të shkruante nga e djathta në të majtë, gjë që rezultonte në një shkrim pasqyrë dhe i cili, ishte e vështirë për t'u lexuar nga të tjerët.

### 8. Adhures i kafshëve!

Ai ishte shumë i mëshirshëm ndaj kafshëve dhe ishte kundër futjes së tyre në kafaze. Leonardo blinte shpesh herë kafshë në kafaze dhe më pas i lironte ato.

### 9. Një vegetarian i rreptë!

Gjatë gjithë jetës së tij, Leonardo

da Vinçi kishte qenë një vegjetarian i rreptë, gjë që supozohet të jetë pasojë e dashurisë së tij për kafshët.

### 10. Incidentet e fëmijërisë!

Leonardo mbante shenja vetëm dy nga incidentet e fëmijërisë: njëri ishte kur një balonë ra nga qielli dhe bishti i saj i lëndoi fytyrën. I dyti kur zbuloi një shpellë ndërsa po eksploronte në male dhe u ndje i tmerruar nga që mendonte se aty mund të

ndodheshin disa përbindësia.

### 11. Shtëpia e fëmijërisë!

Kush nuk dëshiron të eksplorojë shtëpinë e këtij artisti të madh të Rilindjes! Shtëpia e fëmijërisë e Leonardos ndodhet në një fshat të quajtur Anchiano brenda qytetit të Vinçit në Firence. Shtëpia është konvertuar në një lloj muzeu të veprave të famshme të Leonardos. Shtëpia u rihap për publikun në qershor të vitit 2012.



# Japoni, kush është perandori i ri (dhe mund të përdorë mediat sociale)

Debutimi me frak të zi dhe buzëqeshje enigmatike (por e bukur). Vlerësim për babain e tij, Akihito, i cili abdikoi në moshën 85-vjeçare (dhe pas 30 vjetësh të mbretërimit të tij): “Madhëria e tij është tani Perandor”

Naruhito u ngjit në Fronin e Krizantemës dhe ky është viti 1 i epokës Reiwa dhe Japonia shpreson për një rregull të ri dhe një harmoni të re. Ka qenë ora 10:30 në Tokio kur ka filluar ceremonia.

## Rituali dhe mysafirët

Në “Matsu no Ma”, dhoma me dysheme me pisha në zemër të pallatit, ku një ditë para se të abdikojë pas tridhjetë viteve të mbretërimit të Akihito, euhanjtë hyjnë duke bartur thesaret e shenjta të mbyllura në kuti (një shpatë, xhevahir dhe një pasqyrë), dy vulat, vulën e shtetit dhe atë perandorake. Në podium ka vetëm një karrige druri, e thjeshtë. Por perandori i ri nuk pritët të ulet. Dje së bashku me Akihito ishte gruaja e tij Masako, sot Naruhito është vetëm: kjo pjesë e ceremonisë përjashton princeshat.

Akti i dytë i ngjitjes në fron ka një tingull të shkurtër. Naruhito lexoi nga një pergamene disa fjalë pothuajse të gjitha të dedikuara për babain. Ai pranoi “Madhëria e tij tani emëruese e perandorit”, të ketë frymëzuar dhe “me dhembshuri i shërbeu popullit japonez për tridhjetë vjet”.

## Gruaja e perandorit

Gjashtë princeshat e familjes ishin gjithashtu të pranishme, më në fund. Në podium, pranë

Naruhito, ishte Masako, 55 vjeç, gruaja e perandorit të ri. Edukuar në Harvard dhe Oksford, ajo ishte një diplomate e shkëlqyer karriere kur u martua me princin e kurorës Naruhito më 1993. Pastaj Masako u sëmur: pas një qëndrimi shumë të gjatë u bë e ditur se vuante nga “çrregullimi i adaptimit”.

**Përkthyer:** ishte grimcuar nga makina e ceremonisë rigoroze që e kishte detyruar të anulonte personalitetin e saj; ajo gjithashtu ishte torturuar nga detyrimi për të dhënë një trashëgimtar të perandorisë, një fëmijë mashkull. Ajo kishte vetëm një fëmijë (Aiko, në vitin 2001), duke zhgënjyer tradicionalistët e njohur. Kohët e fundit Masako është shëruar, tha se ndihej i pasigurt, por me gjithë brishtësinë e tij, ai premtoi se do t'i shërbente popullit duke përmbushur detyrat e tij të reja perandorake. Në vitin 2006 lindi e një mashkulli, Hisahito, i biri i Akishinos, vël-lai më i vogël i Naruhitos, zgjodhi problemin e trashëgimisë. Mjekët e familjes perandorake paralajmërojnë se princesha është ende e brishtë, duke u nënshtruar uljeve dhe ngritjeve.

## Vitet më të bukura

Historia e Masako sjell suksesin e perandorisë në një dimension njerëzor. Në moshën 59-vjeçare, perandori i ri ka një pamje rinore. Por ka absorbuar goditje të forta: presionet për të pasur një djalë dhe depresionin e Masakos, të thyer nga tejkalmi i kufizimeve absurde dhe të përjetshme të vendosura nga gjykata, duhet ta kenë vënë në provë. Në të kaluarën, Naruhito



dolinë pah, duke kritikuar publikisht sistemin që e bëri gruan e tij të sëmure. Një fakt i jashtëzakonshëm, kështu që ai donte të ishte një njeri i familjes përpara një sovran.

Naruhito ka studiuar në Oksford, i specializuar në studimin e Thames, është i ndjeshëm ndaj problemeve mjedisore, ka shkruar një memoar për atë që ai e quan “vitet më të mira të jetës sime” në Angli, kur ai duhej (mundte) t'i vinte vetë këmbët në lava-triçe.

## Tundimi i mediave sociale

Konstitucionalistët e Tokios dhe shkencëtarët politikë argumentojnë: çfarë roli do të luajë perandori i ri? A mund të ruajë të drejtën për të shprehur pikëpamjet e tij? Apo do të duhet të qëndrojë i qetë dhe të kufizohet në përhëndetjen e të afërmeve të tij nga larg? “Kushtetuta parashikon që perandori të përqendrohet vetëm në funksionet zyrtare dhe ceremoniale”, paralajmëron juristi

Hidetsugu Yagi. Rika Kayama, një psikiatër dhe autor i një libri mbi gratë perandorake, thotë se “çifti Naruhito-Masako duhet të përdorë rrjetet sociale për të nxjerrë mendimet e tyre. Nëse jo me fjalë, së paku me fotografi në Instagram”. Në këtë Naruhito ka vazhduar: nga trashëgimtar në fron ai ka rënë dakord të shkrepë një selfie me turistët-subjektet. Një perandor që sot e kufizoi veten për të ekzistuar nuk do të kishte besim dhe ndjeshmëri të popullit japonez. / Gazeta Shqip



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

# 'Nikli' dhe Llapi shfrytëzojnë gabimin e Prishtinës, Ferizaj ikën nga barazhi



**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 5 MAJ** - Xhiroja e 30-të në IPKO Superligën e Kosovës në Futboll ka sjellë rezultate mjaft interesante. Prishtina është ndalur në barazim nga Drita, kurse këtë gabim të kryeqytetasve e kanë shfrytëzuar Feronikeli që ka krijuar dy pikë diferencë dhe Llapi që me fitoren ndaj Trepçës '89 e ka rrëmbyer pozitën e dytë. Ndërkaq Ferizaj me fitoren ndaj Lirisë ka ikur përkohësisht nga zona e barazhit. Fitore bindëse ka shënuar Ballkani ndaj KEK-ut, kurse Flamurtari ka marrë tri pikë ndaj Gjilanit.

## Llapi - Trepça '89 4-1

Llapi e vazhdon garën për titull, pasi të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti" e mposhti skuadrën e Trepçës '89 (4-1). Ahmet Januzi shënoi dy gola, kurse një tjetër e shtoi Behar Maliqi për fitoren e radhës të skuadrës së drejtuar nga Tahir Batatina, kurse të vetmin gol për mysafirët e realizoi Lassine Traore. Skuadra e Llapit është në formë të jashtëzakonshme dhe kjo fitore do të jetë motiv për ndeshjen e radhës ndaj Prishtinës, e cila zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". Llapi ka grumbulluar 69 pikë, aq sa ka edhe skuadra e Prishtinës.

## Ferizaj - Liria 3-1

Fitore 3-1 ka shënuar edhe Ferizaj ndaj Lirisë. Këto tri pikë e largojnë skuadrën e Bylbyl Sokolit nga zona e barazhit. Mysafirët realizuan të parët nëpërmjet Diellor Beseni në minutën e 21-të. Mirëpo në fund të pjesës së parë vendësit barazuan rezultatin 1-1, me golin e shënuar nga Ermal Krasniqi. Në minutën e 77 Dardan Çerkini realizoi për rezultatin 2-1. Mysafirët nga Prizreni nga minuta e 82-të luajtën pa një lojtar, pasi me karton të kuq u ndëshkua Ragip Thaqi. Vendësit e realizuan edhe një gol në fund të ndeshjes. Autor i golit ishte Dren Gashi.

## Gjilani - Flamurtari 0-1

Flamurtari i Arsim Thaqit ka rrëmbyer tri pikë të reja që janë shumë të rëndësishme në garën për mbijetesë. Kuqezinjtë nga kryeqyteti e mposhtën me rezultat minimal skuadrën e Gjilanit (0-1), kurse golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Shend Kelmendi në minutën e 62-të. Tash Flamurtari ka 38 pikë, kurse Gjilani mbetet në kuotën e 35 pikëve dhe i duhet shumë punë për ta siguruar mbijetesën në elitë.

## KEK-u - Ballkani 0-3

Ballkani ka shënuar tri gola dhe nuk e ka pranuar asnjë në përballje me skuadrën e KEK-ut, e cila është zhvilluar të dielën në Obiliq (0-3). Sulmuesi Jetmir Topalli realizoi dy gola dhe një tjetër e shtoi Aldin Adzoviq në pjesën e parë për t'i siguruar fitoren skuadrës nga Suhareka, e cila tash ka 36 pikë dhe vazhdon të jetë në garë për mbijetesë.

## Drenica - Feronikeli 0-1

Feronikeli ka bërë edhe një hap të madh në rrugëtimin drejt titullit kampion në Superligë, pasi të shtunën e ka mposhtur skuadrën e Drenicës me rezultat 0-1. Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Astrit Fazliu në minutën e 65-të. Pas këtyre tri pikëve skuadra e Feronikelit ka krijuar diferencën ndaj Prishtinës në dy pikë. Në xhiron e radhës Feronikeli e pret Dritën në Drenas, kurse Drenica në kryeqytet i shkon Flamurtarit.

## Drita - Prishtina 1-1

Prishtina ka gabuar në ndeshjen ndaj Dritës që është zhvilluar të shtunën në Gjilan, pasi rezultati final i kësaj ndeshje ishte 1-1. Kampionët në fuqi të elitës kaluan të parët në epërsi në minutën e 14-të, kur nga penalltia shënoi Fidan Gërbeshi. Në minutën e 56 Gauthier Mankenda e barazoi rezultatin pas një asistimi të Armend

**IPKO SUPERLIGA**

Llapi - Trepça '89	3-1
Gjilani - Flamurtari	0-1
Ferizaj - Liria	4-1
KEK-u - Ballkani	0-3
Drenica - Feronikeli	0-1
Drita - Prishtina	1-1

**TABELA**

		PIKË
1. Feronikeli	30	71
2. Llapi	30	69
3. Prishtina	30	69
4. Drita	30	48
5. Trepça '89	30	39
6. Drenica	30	38
7. Flamurtari	30	38
8. Ferizaj	30	37
9. Ballkani	30	36
10. Gjilani	30	35
11. Liria	30	25
12. KEK-u	30	1

Në xhiron e radhës takohen: Prishtina-Llapi, Feronikeli-Drita, Flamurtari-Drenica, Ballkani-Gjilani, Liria-KEK-u, Trepça '89-Ferizaj.

**LIGA E PARË**

Vushtrria - Drenasi	2-0
Bashkimi - Dukagjini	0-3
Vllaznia - Kika	1-0
Trepça - Vëllaznimi	2-4
Istogu - Ramiz Sadiku	1-0
2 Korriku - Fushë Kosova	1-2
Vitja - Arbëria	2-1
Besa - Onix	1-0

**TABELA**

		PIKË
1. Vushtrria	27	63
2. Dukagjini	27	56
3. Besa	27	55
4. Vëllaznimi	27	51
5. Vitja	27	47
6. Onix	27	37
7. Trepça	27	34
8. Arbëria	27	33
9. Istogu	27	32
10. 2 Korriku	27	32
11. Fushë Kosova	27	31
12. Drenasi	27	29
13. Vllaznia	27	28
14. Ramiz Sadiku	27	27
15. Kika	27	26
16. Bashkimi (K)	27	26

Thaqit. Në minutat në vazhdim rastet nuk munguan për të dyja skuadrat, por gola të tjerë nuk kishte dhe skuadrat i ndanë pikët. Drita në xhiron e radhës i shkon "Niklit", kurse Prishtina do të ketë edhe një tjetër derbi përballë vetës, pasi e pret skuadrën e Llapit në stadiumin "Fadil Vokrri".

## SHKURT

### Hasani shënon gol të bukur për Diosgyorin

Futbollisti Florent Hasani ka shënuar një gol të bukur në ndeshjen Diosgyor - Vidi (2-1). Reprezentuesi i Kosovës shënoi në minutën e gjashtë me një goditje të bukur nga distanca. Falë kësaj fitore Diosgyori shtoi gjasat për të mbijetuar në elitën e futbollit hungarez.

### Anulohet minimaratona 5 km

Është anuluar minimaratona 5 km e cila ishte paraparë që të zhvillohej të dielën në mesditë. Organizatorët njoftuan në rrjetin social "Facebook" se për shkak të motit me shi është shtyrë minimaratona dhe në ditë në vijim do të informoheni për datën se kur do të mbahet. Duhet theksuar se të gjitha mjetet e mblledhura nga shitja e numrave do t'u dedikohen fëmijëve me autizëm. Në këtë minimaratona ishte paraparë që të merrte pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

### Shkëndija, kampione e Maqedonisë Veriore

Skuadra tetovare, Shkëndija, ka arritur ta mbrojë titullin në Maqedoninë Veriore, duke u shpallur sot kampione për sezonin 2018/19. Këtë e arriti pas fitores ndaj Rabotniçkit në udhëtim me rezultat prej 0-1. Ennur Totre ishte ai që shënoi golin e fitores për Shkëndijën kur po luhej minuta e 90. Shkëndija shpallet kampione me 72 pikë.

### Marquezi triumfon në Spanjë

Marc Marquez merr kryesimin, pasi ka triumfuar në pistën e Jerezit. Piloti spanjoll ia doli ta kalonte i pari finishin me motorin Honda. Një garë pa probleme për Marquezin, i cili ia doli ta niste i pari dhe të mbyllte në të njëjtin pozicion. Interesante gara për titullin kampion, pasi Aleks Vins, një tjetër spanjoll, renditet në vendin e dytë me vetëm një pikë më pak se Markezi (70 pikë). Garën e sotme Vins e mbylli në vendin e dytë. Piloti i Suzukit la pas vetes Maverik Vinalesin me Yamaha. Valentino Rossi bëri një garë shumë të mirë. Italiani e nisi në vendin e 13-të dhe e mbylli në vendin e gjashtë. Para tij u renditën dyshja e skuadrës Dukati, Andrea Dovizioso dhe Danilo Petrucci.

## Kosova fiton tri medalje në Evropianin e Bodybuildingut dhe Fitnesit

**PRISHTINË, 5 MAJ** - Një e argjendtë dhe dy të bronzta është bilanci i medaljeve të fituara nga garuesit e Kosovës në Kampionatin Evropian të Bodybuildingut dhe Fitnesit, që po mbahet në Santa Susanna të Spanjës. Kushtrim Bajraktaraj fitoi medaljen e

argjendtë në kategorinë deri në 80 kilogramë. Medaljen e bronzit e fitoi Besard Maxharraj, në kategorinë mbi 100 kilogramë, mosha 40-44 vjeçare dhe Granit Kuleta, në kategorinë "Man's Classic Bodybuilding -180 cm". Maxharraj garoi edhe në kate-

gorinë mbi 100 kilogramë dhe doli i pesti. Paraqitje të mirë pati edhe Egzon Hyseni, që doli i katërti në kategorinë deri në 100 kilogramë. Xhevat Asllani zuri vendin e gjashtë në kategorinë -95 kilogramë, ndërsa Leon Berisha dhe Alban Gojani nuk u përfshinë në top

6-she. Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kosovës, Sabri Dragusha, deklaroi për faqen zyrtare të KOK-ut, se Kosova pati respekt të madh, duke u përfaqësuar me simbole shtetërore njësoj si vendet e



tjera, pavarësisht se Spanja nuk e njeh Kosovën.

## Alonso triumfon edhe në dëborë

**STAVELOT, 5 MAJ** - Fernando Alonso triumfoi sot në garën gjashtorëshe të Botërorit Endurance të zhvilluar në pistën belge të SPA. Gara u zhvillua në kushte të vështira atmosferike, teksa binte dëborë dhe pista ishte e rrëshqitshme. Gjithsesi, piloti spanjoll, bashkë me dy shokët e tij të makinës, Sebastian Buemi dhe Kazuki Nakajima, kanë triumfuuar në garën e parafundit të këtij sezoni. Në këtë mënyrë, titulli kampion në Botërorin Endurance po bëhet gjithnjë e më i prekshëm për Alonso me shokë. Atyre do t'u mjaftojë një vend i katërt në garën e fundit sezonale, atë 24-orëshe të La Mansh për t'u shpallur kampionë me makinën Toyota TS050 Hybrid. Ndërkohë që, vetë



skuadra Toyota e siguroi që sot titullin për konstruktorë. Gara u ndërpre për një moment për shkak të dëborës që nisi me dendësi të madhe. Gjithsesi, Alonso nuk dështoi në një pistë të cilën ai e njeh mirë, pasi ka

garuar më parë aty si pilot i Formulës 1. Kjo ishte gara e parafundit e spanjollit në Botërorin Endurance, pasi ai ka deklaruar se pas garës së La Manshit do të mbyllë aventurën në këtë kampionat.

## Houstoni triumfon në shtesë, hap garën për një vend në finalen e 'play-off'-it

**OAKLAND, 5 MAJ** - Për Golden State gjysmëfinalja e Konferencës së Perëndimit nuk do të jetë aspak e lehtë ndryshe nga sa u duk në dy ndeshjet e para me Houstonin. Në fakt, skuadra e Rocketsit fitoi ndeshjen e tretë me kampionët e NBA-s në "Toyota Centes" 126-121 në një sfidë që kërkoi kohën shtesë. Për Warriorsin, Kevin Duranti ishte në një formë të jashtëzakonshme teksa shënoi 46 pikë, por që nuk i mjaftoi skuadrës së drejtuar nga Steve Kerr të regjistronte një tjetër fitore. Gjatë kësaj ndeshjeje teksanët në disa raste krijuan një avantazh prej 11 pikësh kundrejt Golden State, ndërsa në perioidën e tretë kjo diferencë shkoi në 13 pikë. Por 10 pikë të shënuara në dy minutat e para të periodës së katërt nga Duranti bënë që Golden State jo vetëm të qëndrojë në lojë, por edhe ta kërkojë fitoren që me shumë mundësi do ta vendoste edhe fatin e serisë së këtyre përballjeve. Por Houstoni dhe James Hardeni nuk dëshironin një fund të tillë të gjysmëfinaleve dhe bënë tentativat e tyre, ndërkohë që koha e rregullt u mbyll në



barazim duke bërë që sfida t'i kërkojë pesë minutat e shtesës. Në këtë fraksion të lojës Hardeni shënoi 7 nga 14 pikët e Houstonit duke bërë që skuadra e tij të krijonte një diferencë prej 6 pikësh, ndërkohë që krejt ndeshjen e mbylli me 41 pikë personale. Ndërsa Golden State vuajti apatinë e Stephen Curryt në këtë kohë shtesë, nëse ai do të ishte në 100% të formës, rezultati mund të ishte ndryshe. Për

t'u theksuar se Curry gjeti mundësinë edhe për të bërë një figurë të shëmtuar teksa 22 sekonda nga fundi nuk ishte në gjendje të shënonte një kosh të lehtë që do ta reduktonte në 3 pikë diferencën me Houstonin e mund t'i shtonte më shumë emocionet e kësaj sfide në atë kohë të mbetur. Gjithsesi, Golden State vazhdon ta kryesojë serinë e sfidave në 2-1, ndërkohë që edhe sfida e 4 do të luhet në Teksas.

### SHKURT

#### E ardhmja e Hysajt, larg Napolit

E ardhmja e Elseid Hysajt me shumë gjasa do të jetë larg Napolit. Mbrojtësi i kombëtares kuqezi ka kohë që përfillet për një largim nga qyteti jugor i Italisë dhe zërat e dërgonin në Angli te Chelsea. Me mbërritjen e Carlo Ancelottit në krye të napoletanëve, Hysaj nuk ka pasur një vend të sigurt në formacion. "La Gazzeta dello Sport" raporton se menaxheri i Hysajt, Xhufredi, ka njoftuar klubin se Hysaj do të largohet në verë, bashkë me të edhe futbollisti tjetër Mario Rui, që menaxhohet po nga Xhufredi. Së fundmi është folur për tratativa me Interin, por kjo ka për të qenë një verë e "nxehtë" për mbrojtësin e djathtë të kombëtares shqiptare.

#### Keita dhe Firmino mungojnë ndaj Barçës, Salah i dyshim

Liverpooli do të jetë nikoqir i Barcelonës në ndeshjen e dytë gjysmë-finale të Ligës së Kampionëve. Kjo ndeshje do të zhvillohet të martën me fillim nga ora 20:45 në "Anfield" dhe vendësit synojnë të bëjnë befasi pas humbjes 3-0 në "Camp Nou". Megjithatë, një gjë e tillë do të jetë shumë e vështirë jo vetëm për shkak të rezultatit të ndeshjes së parë, por edhe për mungesat që "Reds" do t'i ketë. I pari që është i konfirmuar se do të mungojë është mesfushori Naby Keita. Një emër tjetër që do t'i mungojë klubit anglez është edhe sulmuesi brazilian Roberto Firmino, i cili ka pësuar lëndim në stërvitjet para ndeshjes ndaj Newcastle. Droja e madhe e klubit anglez është mungesa e mundshme e yllit egjiptian Mohamed Salah, i cili është në dyshim për këtë ndeshje pas lëndimit të pësuar në ndeshje ndaj Newcastle, ku u detyrua të zëvendësohet në pjesën e dytë.

#### Roma interesohet për Mourinon

Roma është vënë prej kohësh në ndjekje të një trajneri me peshë, sidomos në arenën ndërkombëtare. Së fundmi është folur shumë për interesimin e verdhekuqve për ish-trajnerin e Chelsea, Antonio Conte, por nga Franca kanë filluar të qarkullojnë lajme në lidhje me një tjetër emër prestigjioz, Jose Mourinho. Është e përditshme "L'Equipe" që flet për mundësinë e kalimit të portugezit në bankinën e Romës, edhe pse ai mund ta marrë drejtimin e Paris Saint-Germainit.

#### Barça nuk heq dorë nga transferimi i Williamit

Kampionia e re e Spanjës, Barcelona, pas tentativave në verën e kaluar dhe në janar, do të hidhet sërish në sulm për ta rëmbyer Williamin nga Chelsea dhe kësaj radhe mund ta ketë më të lehtë. Barcelona do të tentojë edhe një herë tjetër ta transferojë brazilianin në "Camp Nou". Williami ka një kontratë deri në vitin 2020 dhe nëse nuk arrin ta shesë këtë verë, 30-vjeçari mund të largohet me parametër zero një vit më pas ndaj dhe me një ofertë 35 milionë euro drejtuesit e Barcelonës janë të bindur se mund ta bëjnë për vete lojtarin e shumë dëshiruar nga Valverde.

#### Ribery në fund të sezonit largohet nga Bayerni

Franck Ribery është kthyer në një ikonë të Bayern Munchenit, me francezin që është pjesë e bavarezëve prej 12 vjetësh. Shumë dyshime kishte mbi të ardhmen e tij, pasi më parë mesfushori kishte shfaqur dëshirën për të qëndruar të paktën dhe një vit në Munchen. Gjithsesi, pikëpyetjet duket se janë shuar dhe çdo gjë është bërë zyrtare nga vetë klubi gjerman mëngjesin e sotëm. Ribery do ta mbyllë me Bayernin në fund të këtij sezoni, kështu lajmëron në faqen zyrtare klubi bavarez. Gjithashtu, vetë Ribery ka folur për klubin, duke shprehur mirënjohjen e tij për gjithë vitet e kaluara. "Kur erdha në Bavari ishte një ëndërr e bërë realitet. Përralla ka ardhur drejt fundit, por nuk duhet ta harrojmë se çfarë arritëm së bashku. Kemi fituar më shumë se 20 tituj në këto vite", ka deklaruar Ribery, i cili do të vendosë një rekord unik pas pak ditësh, sepse do të shpallet kampion për herë të nëntë në Bundesligë.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

